


Kostoja e dukshmërisë: Dhuna online ndaj grave në jetën politike në Kosovë

Shkurt 2026



Kostoja e dukshmërisë: Dhuna online ndaj grave në jetën politike në Kosovë

Shkurt 2026

Autor: *Demokraci për zhvillim*

Faqosja: *Bubagraphics*

Autorët kanë vepruar me kujdesin dhe ekspertizën e duhur për të siguruar që përmbajtja e këtij raporti të jetë e saktë në kohën e publikimit. Autorët nuk mbajnë përgjegjësi për asnjë humbje të pësuar nga cilido person si rezultat i përdorimit të përmbajtjes së këtij publikimi.

Të gjitha të drejtat mbi këtë publikim, përfshirë të drejtën e autorit, janë në pronësi të Westminster Foundation for Democracy (WFD) dhe mbrohen nga legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar dhe nga e drejta ndërkombëtare. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të kopjohet, shpërndahet, përkthehet apo përshtatet pa lejen paraprake të WFD. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacionet dhe opinionet e paraqitura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë patjetër qëndrimet zyrtare të WFD-së, të themeluesve të saj apo të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. WFD-ja, apo cilido person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për pasojat që mund të rrjedhin nga përdorimi i informacionit të përfshirë në këtë publikim.

Heqje përgjegjësie: Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Westminster Foundation for Democracy, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë medoemos opinionet dhe pikëpamjet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Përmbajtja

Hyrje	7
Metodologjia	9
Kufizimet metodologjike	10
1. Monitorimi i automatizuar digjital	12
1.1 Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetarë të komunave	12
<i>Mbulimi mediatik i grave candidate për kryetare të komunave</i>	<i>12</i>
<i>Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetar të komunës së Prishtinës</i>	<i>14</i>
<i>Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetar të komunës së Prizrenit</i>	<i>16</i>
1.2 Popullariteti dhe gjuha e urrejtjes gjatë fushatës elektorale	18
<i>Popullariteti i grave candidate në rrjetet sociale</i>	<i>18</i>
<i>Gjuha e urrejtjes që synon gratë candidate</i>	<i>20</i>
<i>Gjuha e urrejtjes në garat e monitoruara komunale</i>	<i>21</i>
1.3 Përfundime	22
2. Monitorimi manual i pranisë online të aktorëve politikë	24
2.1 Përfundime	29
3. Përvojat e grave në nivel kombëtar	30
3.1 Ndikimi emocional dhe personal	31
<i>Presioni kumulativ emocional dhe psikologjik</i>	<i>31</i>
<i>Ndërhyrja në jetën private dhe familjare</i>	<i>31</i>
<i>Efektet frenuese dhe disiplinuese në pjesëmarrjen e grave</i>	<i>32</i>
<i>Presioni për tërheqje dhe lodhja emocionale</i>	<i>32</i>
<i>Qëndrueshmëria, kapacitetet e pabarabarta dhe normalizimi i dëmit</i>	<i>32</i>
<i>Ndikimi në diskursin politik dhe cilësinë e demokracisë</i>	<i>33</i>
3.2 Mekanizmat mbështetës	33
<i>Mbështetja familjare si mekanizëm kyç i qëndrueshmërisë</i>	<i>33</i>
<i>Mbështetja nga partitë: selektive, e paqëndrueshme dhe shpesh e pamjaftueshme</i>	<i>33</i>
<i>Solidariteti ndërmjet grave si mekanizëm informal mbështetjeje</i>	<i>34</i>
<i>Raportimi i abuzimit: përdorim selektiv dhe i kushtëzuar i mekanizmave formalë</i>	<i>34</i>
<i>Normalizimi i dhunës dhe vetëmenaxhimi si strategji mbijetese</i>	<i>35</i>

3.3 Ndikimi politik dhe ai që lidhet me zhvillimin e fushatës.....	35
<i>Ndikimi elektoral i gjuhës së urrejtjes.....</i>	35
<i>Ndikimi në strategjinë dhe zhvillimin e fushatës.....</i>	36
<i>Dukshmëria dhe vëmendja mediatike.....</i>	36
<i>Narrativat gjinore dhe targetimi tematik.....</i>	37
3.4 Targetimi me bazë gjinore	37
<i>Angazhimi online dhe ekspozimi ndaj targetimit.....</i>	37
<i>Toni i diskursit online dhe natyra e tij gjinore.....</i>	37
<i>Faktorët nxitës të targetimit: ndërthurja e aktivitetit politik me gjininë</i>	38
<i>Përmbajtja e sulmeve: pamja fizike, familja dhe kompetenca</i>	38
<i>Efektet më të gjera në pjesëmarrjen politike dhe hapësirën demokratike.....</i>	39
3.5 Rekomandimet dhe reflektimet e grave	39
<i>Forcimi i masave mbrojtëse ligjore dhe zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet</i>	39
<i>Roli i partive politike: nga retorika te përgjegjësia.....</i>	39
<i>Përgjegjësia e mediave, platformave dhe edukimi qytetar.....</i>	40
<i>Solidariteti, aleancat dhe përgjegjësia kolektive</i>	40
<i>Mesazhe për gratë që po konsiderojnë kandidimin politik.....</i>	41
<i>Reflektime mbi fushatën dhe vetëpozicionimin.....</i>	41
3.6 Përfundime	41
4. Përvojat e grave në nivel lokal	43
4.1. Ndikimi emocional dhe personal në nivel lokal	43
<i>Presioni kumulativ emocional dhe psikologjik</i>	43
<i>Ndërhyrja në jetën private dhe familjare</i>	44
<i>Efektet frenuese dhe disiplinuese në pjesëmarrjen e grave.....</i>	44
<i>Presioni për tërheqje dhe lodhja emocionale</i>	44
<i>Qëndrueshmëria, kapacitetet e pabarabarta dhe normalizimi i dëmit.....</i>	45
<i>Ndikimi në diskursin politik dhe cilësinë e demokracisë lokale</i>	45
4.2 Mekanizmat mbështetës	45
<i>Mbështetja familjare si mekanizëm kyç i qëndrueshmërisë.....</i>	45
<i>Mbështetja nga partitë: selektive, e paqëndrueshme dhe shpesh e pamjaftueshme</i>	46
<i>Solidariteti ndërmjet grave si mekanizëm informal mbështetjeje.....</i>	47

<i>Raportimi i abuzimit: përdorim selektiv dhe i kushtëzuar i mekanizmave formalë</i>	47
<i>Normalizimi i dhunës dhe vetëmenaxhimi si strategji mbijetese</i>	48
4.3 Ndikimi politik dhe ai që lidhet me zhvillimin e fushatës	48
<i>Ndikimi elektoral i gjuhës së urrejtjes</i>	48
<i>Ndikimi në strategjinë dhe zhvillimin e fushatës</i>	49
<i>Dukshmëria dhe vëmendja mediatike</i>	49
<i>Narrativat gjinore dhe targetimi tematik</i>	50
4.4 Targetimi me bazë gjinore	50
<i>Angazhimi online dhe ekspozimi ndaj targetimit</i>	50
<i>Toni i diskursit online dhe natyra e tij gjinore</i>	51
<i>Faktorët nxitës të targetimit: ndërthurja e aktivitetit politik me gjininë</i>	51
<i>Përmbajtja e sulmeve: pamja fizike, familja dhe kompetenca</i>	52
<i>Efektet më të gjera në pjesëmarrjen politike dhe hapësirën demokratike</i>	52
4.5 Rekomandimet dhe reflektimet e grave	53
<i>Forcimi i masave mbrojtëse ligjore dhe zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet</i>	53
<i>Roli i partive politike: nga retorika te përgjegjësia</i>	53
<i>Përgjegjësia e mediave, platformave dhe edukimi qytetar</i>	54
<i>Solidariteti, aleancat dhe përgjegjësia kolektive</i>	55
<i>Mesazhe për gratë që po konsiderojnë kandidimin politik</i>	55
<i>Reflektime mbi fushatën dhe vetëpozicionimin</i>	55
4.6 Përfundime	56

Hyrje

Komunikimi politik në internet po bëhet gjithnjë e më shumë një arenë qendrore e garës elektorale, duke ndikuar në dukshmëri, në ndërtimin e narrativave dhe në angazhimin e votuesve. Aktualisht, ai është shndërruar edhe në një mjedis të rëndësishëm për shfaqjen e dhunës me bazë gjinore, ku gratë që dalin kandidatë në politikë ekspozohen në mënyrë disproporcionale ndaj gjuhës së urrejtjes, ngacmimeve dhe narrativave diskriminuese. Në Kosovë, sikurse në shumë kontekste demokratike, kjo dukuri paraqet një risk në rritje jo vetëm për pjesëmarrjen e grave në politikë, por edhe për cilësinë, përfshirjen e plotë dhe integritetin e proceseve demokratike.

Ky raport shqyrton dhunën online me bazë gjinore ndaj grave në politikë (dukuri që në diskursin dhe literaturën e gjerë në gjuhën angleze njihet si *Violence Against Women in Politics*, shkurt VAWP) gjatë cikleve elektorale të vitit 2025, përkatësisht gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të mbajtura në vitin 2025. Raporti e trajton gjuhën e urrejtjes online dhe komunikimin politik diskriminues jo si incidente të izoluara apo si shprehje të armiqësisë individuale, por si forma sistemore dhe kumulative të dhunës politike që ndikojnë në përcaktimin e asaj se kush duhet të marrë pjesë në politikë, në çfarë kushtesh dhe me çfarë kostoje personale. Duke kombinuar monitorimin digjital në shkallë të gjerë me intervista cilësore të thelluara, raporti synon të paraqesë si shtrirjen e shkeljeve online ashtu edhe ndikimin e tyre të përjetuar nga gratë që dalin kandidatë në politikë.

Analiza mbështetet në përvojën e kamotshme të organizatës *Demokraci për zhvillim* (D4D) në monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes së dëmshme online gjatë proceseve elektorale. Duke përdorur një qasje të metodave të kombinuara, raporti dokumenton modelet e mbulimit mediatik, dinamikat specifike të platformave dhe shpërndarjen e përmbajtjes diskriminuese me bazë gjinore sipas komunave, aktorëve politikë dhe periudhave kohore. Vëmendje e veçantë i kushtohet fazës së para fushatës dhe fazave përmbyllëse të garës elektorale, ku armiqësia online duket se intensifikohet, ndërkohë që mekanizmat institucionalë mbrojtës shpesh janë më të dobët.

Përtej trendeve sasiore, raporti vë në qendër zërat e vetë grave kandidatë. Përmes intervistave cilësore, raporti shqyrton pasojat emocionale, personale dhe politike të abuzimit online, përfshirë presionin psikologjik kumulativ, ndërhyrjen në jetën private dhe familjare, efektet dekurajuese në pjesëmarrjen politike dhe presionin për t'u tërhequr nga jeta publike. Këto gjetje tregojnë se si gjuha e urrejtjes online përforcon strukturat e pushtetit të bazuara në gjini, funksionon si mekanizëm disiplinues dhe normalizon praktikën përjashtuese në politikë.

Raporti shqyrton gjithashtu mekanizmat praktikë të mbrojtjes, përfshirë rrjetet familjare, partitë politike, solidaritetin ndërmjet grave dhe kanalet formale të raportimit. Gjetjet shpërfaqin boshllëqe të konsiderueshme ndërmjet zotimeve formale për barazi gjinore dhe mbrojtjes praktike që u ofrohet grave kandidatë, ku përgjegjësia për menaxhimin e dëmit shpesh zhvendoset tek individët dhe jo tek institucionet. Këto dinamika sjellin riskun e thellimit të pabarazive strukturore dhe dekurajimit të brezave të ardhshëm të grave që të mos angazhohen në politikë.

Në fund, raporti ofron rekomandime dhe reflektime të nxjerra drejtpërdrejt nga përvojat e grave kandidate, duke theksuar nevojën për përgjigje të koordinuara ligjore, politike dhe shoqërore kundër dhunës ndaj grave në politikë. Këto rekomandime përfshijnë zbatimin më të fuqishëm të kuadrit ekzistues ligjor, përgjegjësi më të qarta brenda partive politike, praktika më të përgjegjshme mediatike dhe solidaritet kolektiv që nuk mbështetet vetëm në qëndrueshmërinë individuale të grave.

Duke dokumentuar si modelet ashtu edhe pasojat e dhunës online me bazë gjinore, ky raport synon të kontribuojë në hartimin e politikave të bazuara në fakte, në një debat publik të bazuar në informim paraprak dhe në reagime institucionale më të fuqishme. Adresimi i dhunës ndaj grave në politikë është thelbësor jo vetëm për avancimin e barazisë gjinore, por edhe për mbrojtjen e pjesëmarrjes demokratike dhe për të siguruar që konkurrenca politike të mbetet e hapur, substanciale dhe përfshirëse për të gjithë.

Metodologjia

Ky raport aplikon një dizajn kërkimor me metoda të përziera për të monitoruar, analizuar dhe dokumentuar në mënyrë sistematike dhunën online me bazë gjinore që synon gratë kandidate gjatë procesit elektoral. Duke u mbështetur në më shumë se katër vite përvojë në monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes së dëmshme në hapësirën digjitale, *Demokraci për zhvillim* (D4D) përdor një qasje metodologjike të integruar që kombinon monitorimin digjital të automatizuar në shkallë të gjerë, shqyrtimin sistematik manual të përmbajtjes dhe intervista cilësore të thelluara me gra kandidate. Ky dizajn siguron si gjerësi ashtu edhe thellësi të analizës, duke mundësuar identifikimin e modeleve dhe trendeve strukturore në diskursin online, ndërkohë që kap edhe përvojat e drejtpërdrejta dhe ndikimin personal të sulmeve me bazë gjinore në hapësirën digjitale.

Komponenti i parë i metodologjisë përbëhet nga monitorimi digjital i automatizuar, i realizuar përmes platformës së monitorimit digjital Pikasa. Pikasa mundëson analizë në kohë reale dhe në shkallë të gjerë të përmbajtjes online në mediat digjitale dhe rrjetet sociale. Gjatë periudhës së fushatës elektorale, platforma monitoroi përmbajtje nga më shumë se 100 media online, si dhe mijëra postime dhe ndërveprime të përdoruesve në platformat kryesore të mediave sociale, përfshirë Facebook, Instagram, TikTok, YouTube dhe X (ish-Twitter).

Duke përdorur algoritma të mësimit automatik dhe analiza të automatizuara të përmbajtjes, platforma skanoi në mënyrë sistematike artikuj, postime, komente dhe ndërveprime të përdoruesve me qëllim identifikimin e përmbajtjes potencialisht të dëmshme ose abuzive. Vëmendje e veçantë iu kushtua identifikimit të gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore, gjuhës seksiste, talljeve për trupin, sulmeve personale, kërcënimeve dhe narrativave të dezinformimit që synojnë gratë kandidate. Përmbajtja e identifikuar më pas u kategorizua sipas llojit të shkeljes, modeleve të shfaqjes së saj (nëse bëhej fjalë për incidente të izoluara apo për sulme të përsëritura dhe potencialisht të koordinuara), objektivit specifik të përmbajtjes (si kandidatet individuale, partitë politike apo grupe më të gjera të grave kandidate), si dhe sipas nivelit të ndërveprimit të gjeneruar, përfshirë pëlqimet, shpërndarjet dhe komentet. Ky nivel analize mundësoi matjen si të shkallës ashtu edhe të dukshmërisë së dhunës online me bazë gjinore dhe lehtësoi identifikimin e narrativave të përsëritura dhe të periudhave me risk të lartë gjatë fushatës.

Për të plotësuar monitorimin e automatizuar dhe për të rritur saktësinë kontekstuale, komponenti i dytë i metodologjisë përfshiu monitorimin sistematik manual të pranisë online të aktorëve politikë. Një ekip i dedikuar monitorimi realizoi shqyrtime të përditshme të përmbajtjes së publikuar nga partitë politike dhe kandidatët individualë në llogaritë e tyre zyrtare digjitale gjatë gjithë periudhës së fushatës së zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Ky shqyrtim manual u fokusua jo vetëm në identifikimin e përmbajtjes shprehimisht abuzive, por edhe në analizimin e tonit, gjuhës, imazherisë dhe inkuadrimin në komunikim për qëllime fushate. Vëmendje e veçantë iu kushtua rasteve të narrativave diskriminuese, poshtëruese ose seksiste, përfshirë përmbajtjen që synonte gratë në bazë të gjinisë, pamjes fizike, roleve familjare apo pritjeve si konstrakte shoqërore.

Për dokumentim sistematik u zhvillua një panel i strukturuar monitorimi për secilën komunë të përfshirë në studim. Paneli përmbante një listë të kandidatëve dhe lidhje me llogaritë e tyre zyrtare online, si dhe evidencë të detajuar të rasteve të identifikuara të gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore ose stereotipizimit të dëmshëm. Secili rast i evidentuar përfshinte prova të arkivuara, si pamje ekrani, shënime të datës dhe kohës, informacion mbi platformën dhe referime të burimit. Platformat kryesore të monitoruara ishin Facebook, TikTok, X, YouTube dhe Instagram, duke reflektuar rolin e tyre qendror në komunikimin politik, mobilizimin e audiencës dhe amplifikimin e narrativave gjinore në diskursin elektoral.

Komponenti i tretë metodologjik përbëhej nga intervista cilësore të thelluara, të dizajnuara për të vendosur në kontekst gjetjet sasore dhe për të shqyrtuar pasojat personale, emocionale dhe politike të abuzimit online. U realizuan intervista gjysmë të strukturuar me 18 gra candidate që morën pjesë në procesin elektoral, përfshirë 8 në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 dhe 10 në zgjedhjet lokale të vitit 2025. Pjesëmarrëset u përzgjedhën në bazë të dukshmërisë së tyre gjatë fushatës dhe shkallës së ekspozimit ndaj ngacmimit online.

Intervistat trajtuan ndikimin emocional dhe psikologjik të gjuhës së urrejtjes online, ndikimin e saj në angazhimin politik dhe strategjitë e fushatës, si dhe disponueshmërinë dhe efektivitetin e mekanizmave mbështetës brenda partive politike, institucioneve dhe familjeve. Vëmendje e veçantë iu kushtua identifikimit të dimensioneve gjinore specifike të sulmeve, siç janë sulmet që lidhen me pamjen fizike, jetën familjare, moralin apo angazhimin për barazi gjinore. Intervistat gjithashtu mblodhën reflektimet dhe rekomandimet e pjesëmarrëseve lidhur me mekanizmat e raportimit, reagimet institucionale dhe masat e nevojshme për forcimin e mbrojtjes ndaj dhunës online me bazë gjinore.

Duke kombinuar analizën e automatizuar të të dhënave në shkallë të gjerë, shqyrtimin sistematik manual dhe perspektivat e thelluara cilësore, metodologjia ofron një kuptim gjithëpërfshirës si të dinamikave strukturore ashtu edhe të pasojave individuale të dhunës online me bazë gjinore në kontekste elektorale. Kjo qasje e integruar siguron që modelet statistikore të interpretohen krahas narrativave personale, duke mundësuar nxjerrjen e përfundimeve të bazuara në fakte dhe të rëndësishme për hartimin e politikave.

Kufizimet metodologjike

Megjithëse qasja me metoda të përziera forcon qëndrueshmërinë e analizës, duhet të theksohen disa kufizime. Pavarësisht kriterëve të qarta të kodimit, dallimi ndërmjet kritikës politike dhe shkeljeve me bazë gjinore mund të kërkojë interpretim kontekstual. Identifikimi i automatizuar, i plotësuar me verifikim njerëzor, mund të mos arrijë të kapë formë më të nuancuara, të koduara ose specifike sipas kontekstit të abuzimit, veçanërisht në mjedisin shumëgjuhësh të Kosovës. Për më tepër, monitorimi ishte i kufizuar në përmbajtjen me akses publik në media të përzgjedhura dhe në platformat kryesore të mediave sociale, duke përjashtuar përmbajtjen private ose të fshirë, si dhe përmbajtjen që ndikohet nga algoritmat specifike të platformave për dukshmërinë e përmbajtjes. Këto

kufizime pasqyrojnë kufijtë teknikë dhe kufizimet e aksesit që karakterizojnë kërkimin në fushën e monitorimit digjital.



1. Monitorimi i automatizuar digjital

Kjo pjesë paraqet gjetjet e gjeneruara përmes **monitorimit të automatizuar digjital**, të realizuar duke përdorur platformën Pikasa. Monitorimi mundësoi analizë në kohë reale dhe në shkallë të gjerë të përmbajtjes online të publikuar në media digjitale dhe në platformat kryesore të mediave sociale gjatë periudhës elektorale. Duke aplikuar analiza të përmbajtjes të bazuara në algoritma të mësimit automatik, sistemi identifikoi dhe kategorizoi përmbajtje potencialisht të dëmshme, me fokus të veçantë në gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore, narrativat seksiste, sulmet personale, kërcënimet dhe dezinformimin që synon gratë kandidate.

Rezultatet e paraqitura më poshtë ofrojnë një pasqyrë të **shkallës, shpërndarjes dhe dukshmërisë** së shkeljeve të identifikuara dhe shërbejnë si bazë përshkruese për analizën dhe interpretimin e mëtejshëm të trendeve në komunikimin politik online me bazë gjinore.


1.1 Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetarë të komunave

Mbulimi mediatik i grave kandidate për kryetare të komunave

Monitorimi i mbulimit mediatik që lidhet me gratë kandidate për kryetare komunash gjatë periudhës para-elektorale dhe gjatë fushatës elektorale në vitin 2025 shpërfaq pabarazi të theksuara në dukshmëri, në fokusin tematik dhe në mënyrën e paraqitjes së kandidateve në media. Vëmendja mediatike është e përqendruar kryesisht në një numër të vogël të grave kandidate, ndërsa shumica paraqiten në media në mënyrë të kufizuar dhe të ngushtë.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2025 për kryetarë komunash, 20 gra kandiduan në 13 komuna. Nga të gjithë kandidatët, vetëm një grua fitoi mandatin e kryetares së komunës në komunën e vogël të Ranillugut. Në të gjitha komunat e tjera, gratë kandidate humbën garën, kryesisht për shkak se partitë politike i nominuan ato në komuna ku gjasat për fitore ishin tejet të ulëta. Ky model sugjeron se kandidaturat e grave shpesh përdoren për të demonstruar formalisht përfshirjen gjinore, në vend se të pasqyrojnë një strategji reale elektorale për fitimin e garës për kryetar komune.

Një grup i vogël kandidatesh, veçanërisht Besa Shahini (306 artikuj) dhe Emilija Redžepi (250 artikuj), dominojnë dukshmërinë e përgjithshme në media. Mbulimi për to është i gjerë dhe në masë të madhe i formësuar nga çështje kombëtare dhe politike me rëndësi të madhe, më shumë sesa nga agjendat e qeverisjes lokale. Për të dyja kandidatet, temat që lidhen me, çështjet institucionale dhe kushtetuese, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të raportimit mediatik. Kjo sugjeron se gratë kandidate që pozicionohen brenda debateve më të gjera kombëtare ose gjeopolitike kanë tendencë të marrin më shumë vëmendje të vazhdueshme nga mediat.

Figura 1. Mbulimi mediatik i grave kandidate për kryetare komunash në zgjedhjet lokale 2025 (numri i artikujve)

Kandidatet me nivel mesatar të mbulimit mediatik, si Xhevahire Izmaku, Albulena Balaj-Halimaj, Natyra Kuçi dhe Arta Vokshi Nallbani, mbulohen kryesisht përmes një kombinimi temash që lidhen me zhvillimin lokal, përfshirë investimet, punësimin dhe angazhimin e diasporës, si dhe përmes narrativave më të gjera politike që lidhen me veriuin e Kosovës dhe marrëdhëniet ndëretnike. Te disa nga këto kandidatë shfaqen referime për barazinë gjinore, por mbeten dytësore dhe marginale në krahasim me temat që lidhen me sigurinë ose identitetin.

Për kandidatet me dukshmëri më të ulët mediatike, mbulimi bëhet gjithnjë e më i ngushtë dhe i përsëritur, shpesh i dominuar nga një çështje e vetme politike. Ky model është veçanërisht i dukshëm te kandidatet nga komunat me shumicë serbe, ku raportimi përqendrohet kryesisht te Lista Serbe, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, targat e automjeteve dhe qeverisja në veri të Kosovës. Në këto raste, gratë kandidatë paraqiten kryesisht si përfaqësuese politike në kuadër të mosmarrëveshjeve etnike ose territoriale, dhe jo si kandidatë me platforma të veçanta politike për zhvillimin lokal.

Vlen të theksohet se prioritetet e qeverisjes lokale, si shërbimet sociale, shëndetësia, arsimi, mjedisi apo menaxhimi komunal, janë kryesisht të nënpërfaqësuar në mbulimin mediatik të shumicës së grave kandidatë. Edhe kur përmenden çështje si investimet apo infrastruktura, ato shpesh paraqiten në kuptim të përgjithshëm politik dhe jo përmes propozimeve konkrete politike të vetë kandidatëve.

Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetar të komunës së Prishtinës

Të dhënat nga monitorimi mediatik për garën për kryetar të komunës së Prishtinës shpërfaqin një shpërndarje shumë të pabarabartë të mbulimit ndërmjet kandidatëve, si për nga vëllimi i raportimit ashtu edhe për nga inkuadrimi tematik. Vëmendja mediatike është e përqendruar kryesisht te një grup i vogël burrash të spikatur si kandidatë kryesorë, ndërsa gruaja kandidatë ka marrë dukshmëri dukshëm më të kufizuar dhe është trajtuar në një gamë më të ngushtë temash.

Ndër kandidatët, Përparim Rama ka marrë vëllimin më të lartë të mbulimit mediatik, me 2,215 artikuj. Prania e tij në media dominohet nga temat që lidhen me investimet, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të raportimit, të ndjekura nga çështje si korrupsioni, shpronësimi dhe projektet infrastrukturore. Ky model sugjeron një paraqitjen në një kuadër që thekson qeverisjen ekzekutive, zhvillimin urban dhe vendimarrjen administrative. Dukshmëria e tij përforcohet më tej nga vëmendja e vazhdueshme e një numri të kufizuar të mediave shumë aktive, çka tregon një fokus të fortë editorial në kandidaturën e tij.

Uran Ismaili pason nga afër me 1,975 artikuj, duke reflektuar gjithashtu një prani të madhe mediatike. Megjithatë investimet mbeten tema dominuese, mbulimi i tij përfshin edhe një fokus më të theksuar në barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Ky shpërndarje më e gjerë tematike sugjeron një inkuadrim politik më të larmishëm që kombinon narrativat e zhvillimit lokal me çështje sociale dhe të të drejtave, duke e pozicionuar atë si kandidat me profil menaxherial dhe reformues.

Për dallim, Hajrulla Çeku është përmendur në 538 artikuj, duke mbetur dukshëm pas dy kandidatëve kryesorë. Edhe pse investimet mbeten tema më e dukshme, mbulimi i tij


përfshin një theks më të madh në korrupsionin, papunësinë dhe presionet ekonomike si inflacioni. Kjo tregon paraqitje në një kuadër që anon më shumë drejt sfidave socio-ekonomike dhe çështjeve sistimore sesa drejt projekteve të mëdha kapitale.

Bekë Berisha shfaqet në 292 artikuj, me mbulim që përqendrohet kryesisht në investimet dhe çështjet institucionale. Vëllimi relativisht i kufizuar i raportimit dhe fokusi i ngushtë tematik sugjerojnë një dukshmëri më të ulët mediatike dhe një prani më episodike në raportimin e fushatës, duke ofruar më pak hapësirë për pozicionim të qëndrueshëm politik.

Në këtë kontekst, mbulimi mediatik i Besa Shahinit ilustron më tej pabarazitë gjinore si në dukshmëri ashtu edhe në mënyrën e paraqitjes në kuadër të caktuar. Shahini është përmendur në 306 artikuj, duke u pozicionuar në një nivel të ngjashëm dukshmërie me Bekë Berishën, por dukshëm më poshtë se tre burrat që ishin kandidatët kryesorë. Megjithatë investimet mbeten tema më e spikatur në mbulimin e saj mediatik (56 artikuj, 10%), prania e saj në media është më e fragmentuar dhe më pak e konsoliduar tematikisht.

Ndryshe nga burrat që u shquan si kandidatë kryesorë, mbulimi i të cilëve është i ankoruar fort në performancën qeverisëse dhe zhvillimin urban, raportimi për Shahinin përqendrohet më shpesh në çështje politike kombëtare të ndjeshme. Barazia gjinore shfaqet vetëm në mënyrë marginale në mbulimin e saj (6 artikuj, 1%), ndonëse shpesh konsiderohet një fushë politike e lidhur me gratë candidate, ndërsa çështje si gjuha e urrejtjes, rritja e pagave dhe ndotja e ajrit marrin vëmendje të kufizuar.

Figura 2. Numri i artikujve për kandidatët për kryetar të komunës së Prishtinës



Ky model sugjeron se kandidatura e Shahinit rrallë paraqitet në kuadër të agjendës së saj të politikave lokale ose kapacitetit të saj për udhëheqje ekzekutive, dhe më shpesh vendoset në kontekstin e debateve më të gjera politike. Në krahasim me burrat kandidatë me nivele të ngjashme apo edhe më të ulëta të mbulimit mediatik, ajo merr më pak vëmendje të vazhdueshme për çështjet kyç të qeverisjes komunale, gjë që përforcon një mjedis mediatik në të cilin gratë kandidate hasin vështirësi për të siguruar dukshmëri të qëndrueshme dhe të përqendruar në politika.

Krahasimi nxjerr në pah një pabarazi të qartë në trajtimin mediatik. Ndërsa burrat kandidatë, veçanërisht ata që perceptohen si favoritë në garë, përfitojnë nga një mbulim i gjerë dhe tematikisht i qëndrueshëm që fokusohet në investime dhe qeverisje, mbulimi i vetmes grua kandidate mbetet më i kufizuar, më i fragmentuar dhe më i politizuar. Kjo pabarazi sjell riskun e kufizimit të ekspozimit të votuesve ndaj qëndrimeve thelbësore programore të grave kandidate dhe të përforcimit të pabarazive strukturore në përfaqësimin mediatik në garat elektorale lokale.

Mbulimi mediatik i kandidatëve për kryetar të komunës së Prizrenit

Mbulimi mediatik i kandidatëve në garën për kryetar komunës së Prizrenit tregon një shpërndarje mesatare, por të pabarabartë të dukshmërisë, me dallime të dukshme si në vëllimin e raportimit ashtu edhe në inkuadrimin tematik të fushatave të kandidatëve. Në krahasim me Prishtinën, niveli i përgjithshëm i mbulimit është më i ulët. Megjithatë, mediat lokale dhe ato me orientim kombëtar luajnë një rol më të theksuar në formësimin e narrativës. Vëmendja mediatike nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe ka tendencë të privilegjojë disa kandidatë dhe disa korniza tematike në raport me të tjerët.

Shaqir Totaj shfaqet si kandidati më i dukshëm në garën për kryetar të komunës së Prizrenit, me gjithsej 910 artikuj në të cilët ai përmendet. Mbulimi i tij mediatik përqendrohet kryesisht në investime, të cilat përbëjnë 328 referime (23% e të gjitha referimeve tematike). Përmbajtja që lidhet me investimet është e larmishme dhe e lidhur me zhvillimin lokal, duke përfshirë projekte infrastrukturore në Bazhdërhane, investime në objekte sportive, ndërtimin e rrugëve dhe përmirësimin e rrjetit rrugor në zonat rurale. Shkalla e lartë e dukshmërisë së Totajt nxitet nga mbulimi i vazhdueshëm në disa media kryesore kombëtare dhe lokale, çka tregon një vëmendje të gjerë editoriale dhe jo përqendrim në një burim të vetëm mediatik.

Ndër burrat e tjerë kandidatë, Artan Abrashi ka marrë një nivel të lartë, por dukshëm dytësor të vëmendjes mediatike, me 282 artikuj. Mbulimi i tij dominohet fuqishëm nga temat që lidhen me investimet, të ndjekura nga shpronësimi, angazhimi i diasporës dhe korrupsioni. Referimet për barazinë gjinore dhe për çështje më të gjera politike shfaqen vetëm në mënyrë marginale. Përqendrimi tematik dhe përsëritja e temave në një numër të kufizuar të mediave e pozicionojnë Abrashin si një sfidues të rëndësishëm në narrativën mediatike, që paraqitet kryesisht në kuadër të prizmit të zhvillimit dhe qeverisjes.

Driton Selmanaj pason me 180 artikuj, duke reflektuar një dukshmëri mesatare. Paraqitja e tij në media përqendrohet gjithashtu te investimet dhe infrastruktura, ku projektet rrugore dhe kapitale zënë vend të rëndësishëm. Tema të tjera si feja, angazhimi i

diasporës dhe rimëkëmbja ekonomike shfaqen në mënyrë sporadike, duke sugjeruar një narrativë fushate që kombinon mesazhe të orientuara drejt zhvillimit me referime më të gjera socio-politike, por me më pak qëndrueshmëri sesa ajo e vërejtur në mbulimin e Totajt ose Abrashit.

Për dallim, Besnik Krasniqi (75 artikuj) dhe Zafir Berisha (68 artikuj) kanë marrë dukshëm më pak vëmendje mediatike. Për të dy kandidatët, mbulimi është më i ngushtë dhe dominohet kryesisht nga temat e investimeve, me përmendje të kohëpaskohshme të korrupsionit, barazisë gjinore, papunësisë dhe çështjeve politike të nivelit kombëtar si veriu i Kosovës. Dukshmëria e kufizuar e tyre sugjeron një prani më episodike në media, duke ofruar më pak mundësi për pozicionim të qëndrueshëm politik ose për diferencim të kandidatëve.

Ndërsa toni i mbulimit mediatik për Totajn është kryesisht neutral ose informativ, analiza tregon se shumica e gjuhës së urrejtjes që lidhet me kandidaturën e tij buron nga komentet e përdoruesve në postimet e tij në rrjetet sociale. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse artikujt e portaleve nuk e paraqesin kandidatin në mënyrë negative, komentet e gjeneruara nga përdoruesit në këto postime shpesh përmbajnë gjuhë të urrejtjes. Ky dallim nxjerr në pah hendekun ndërmjet narrativave editoriale të mediave dhe hapësirave të ndërveprimit të audiencës, duke theksuar rolin e dinamikave të mediave sociale në amplifikimin e diskursit armiqësor në mënyrë të pavarur nga kornizat gazetareske.

Në këtë kontekst, mbulimi mediatik i grave kandidate në Prizren shpërfaq modele të veçanta gjinore si në dukshmëri ashtu edhe në mënyrën e paraqitjes. Emilija Redžepi është përmendur në 250 artikuj, duke u renditur ndër kandidatët më të dukshëm për nga vëllimi i raportimit, e dyta pas Artan Abrashit dhe duke tejkaluar disa burra si kandidatë. Megjithatë, pavarësisht kësaj dukshmërie relativisht të lartë, inkuadrimi tematik i mbulimit të saj dallon dukshëm nga ai i burrave kandidatë. Prania e saj në media dominohet kryesisht nga tema politike të ndjeshme në nivel kombëtar, dhe konstituimi i Kuvendit (secila duke përbërë 59% të mbulimit), të ndjekura nga Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, zhvillimet në veri të Kosovës, integrimi në Bashkimin Evropian dhe çështje të sigurisë që lidhen me KFOR-in. Investimet dhe çështjet ekonomike në nivel lokal shfaqen vetëm në mënyrë marginale në mbulimin e saj mediatik.

Ky model tregon se kandidatura e Redžepi-t vendoset më pak në kuadër të perspektivës së pushtetit lokal ose udhëheqjes komunale dhe më shumë si pjesë e debateve më të gjera politike kombëtare dhe ndëretnike. Si rezultat, dukshmëria e saj nuk përkthehet në ekspozim të qëndrueshëm të një agjende të politikave lokale të krahasueshme me atë të burrave që ishin kandidatë kryesorë, pavarësisht numrit relativisht të lartë të artikujve.

Për dallim, Albulena Balaj-Halimaj është përmendur vetëm në 75 artikuj, duke u renditur në të njëjtin nivel të ulët dukshmërie me Besnik Krasniqin dhe Zafir Berishën. Mbulimi i saj është i fragmentuar dhe tematikisht i shpërndarë, ku investimet shfaqen si tema më e shpeshtë, por përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të raportimit të përgjithshëm. Çështje si angazhimi i diasporës, korrupsioni, barazia gjinore, bullizmi dhe gjuha e urrejtjes shfaqen në mënyrë sporadike, secila në një numër shumë të kufizuar artikujsh. Ngjashëm me Redžepi-n, në mbulimin e saj mediatik përfshihen edhe elemente të

politikës së nivelit kombëtar, përfshirë veriun e Kosovës dhe konstituimin e Kuvendit, por pa krijuar një narrativë dominuese.

Krahasimi nxjerr në pah një pabarazi të qartë gjinore në trajtimin mediatik të garës për kryetar të komunës së Prizrenit. Ndërsa burrat kandidatë, veçanërisht ata që perceptohen si favoritë në garë, paraqiten kryesisht përmes raportimeve për investime, infrastrukturë dhe kapacitetin për qeverisje ekzekutive, gratë kandidatë ose politizohen së tepërmi përmes raportimeve për çështje kombëtare dhe identitare, si në rastin e Redžepi-t, ose marginalizohen përmes dukshmërisë së ulët dhe të fragmentuar, si në rastin e Balaj-Halimajt. Temat që lidhen me barazinë gjinore, politikën sociale dhe shërbimet publike lokale mbeten periferike në mbulimin e të gjithë kandidatëve dhe nuk përbëjnë element qendror të raportimit për fushatën.


Ky mjedis mediatik sjell riskun e kufizimit të ekspozimit të votuesve ndaj qëndrimeve materiale programore të grave kandidatë dhe përforcon pabarazitë strukturore në mënyrën se si përfaqësohet udhëheqja politike në nivel komunal.

1.2 Popullariteti dhe gjuha e urrejtjes gjatë fushatës elektorale

Popullariteti i grave kandidatë në rrjetet sociale

Të dhënat nga rrjetet sociale tregojnë dallime të dukshme në popullaritetin dhe në nivelin e ndërveprimit të audiencës me gratë kandidatë gjatë fushatës elektorale. Megjithatë aktiviteti me postime nga kandidati në kandidat është i ndryshëm, nivelet e ndërveprimit tregojnë një hierarki të qartë për sa i përket rezonancës publike dhe shtrirjes online.

Figura 3. Numri i artikujve për kandidatët për kryetar të komunës së Prizrenit




Natyra Kuçi shfaqet si kandidatja më e popullarizuar për nga ndërveprimi i përgjithshëm. Me 87 postime që kanë gjeneruar 59,825 ndërveprime, përmbajtja e saj ka arritur norma dukshëm më të larta të ndërveprimit krahasuar me gratë e tjera candidate. Kjo sugjeron një aftësi të fortë për mobilizimin e audiencës dhe për ruajtjen e dukshmërisë së vazhdueshme, e cila mund të jetë nxitur nga një kombinim i njohjes së lartë publike, pozicionimit politik polarizues dhe rrjeteve aktive të mbështetësve.

Besa Shahini renditet e dyta për nga popullariteti, duke publikuar më së shumti ndër gratë candidate (98 postime) dhe duke gjeneruar 22,239 ndërveprime. Megjithatë nivelet e ndërveprimit të saj janë dukshëm më të ulëta se ato të Kuçit, ato mbeten ndjeshëm më të larta se të grave të tjera candidate. Ky model tregon interes të qëndrueshëm të audiencës dhe një bazë relativisht stabile mbështetëse, duke reflektuar profilin e saj tashmë të konsoliduar publik dhe një narrativë fushate të fokusuar më shumë në çështje sociale sesa në konfrontim politik.

Një rënie e ndjeshme në ndërveprim vërehet te kandidatet e tjera. Xhevahire Izmaqu (60 postime; 1,873 ndërveprime) dhe Vildane Latifi (49 postime; 1,701 ndërveprime) shfaqin aktivitet mesatar publikimesh, por ndërveprim të kufizuar nga audienca. Kjo sugjeron se frekuenca më e lartë e publikimeve nuk përkthehet patjetër në rritje të popullaritetit ose të dukshmërisë pa amplifikim më të gjerë mediatik ose pa rëndësi më të lartë politike.

Egzona Tërdevci regjistron nivelin më të ulët të popullaritetit, me vetëm 5 postime që kanë gjeneruar 882 ndërveprime. Aktiviteti i saj i kufizuar dhe ndërveprimi i ulët tregojnë një prani marginale në hapësirën e fushatës online, duke reduktuar mundësitë për komunikim me votuesit dhe për shpërndarjen e mesazheve të fushatës.

Figura 4. Popullariteti i grave candidate në faqet e Facebook-ut



Të dhënat tregojnë një përqendrim të theksuar të popullaritetit online në një numër të vogël të grave candidate. Ndërsa Kuçi dhe Shahini kanë arritur shtrirje dhe ndërveprim të konsiderueshëm, gratë e tjera candidate kanë mbetur kryesisht në periferi të fushatës digjitale. Këto dallime pasqyrojnë pabarazi më të gjera strukturore në dukshmëri, në akses në rrjete mbështetëse dhe në amplifikim mediatik, duke përforcuar sfidat me të cilat përballen gratë candidate, veçanërisht ato me njohje më të ulët publike, në përdorimin e rrjeteve sociale si mjet efektiv të fushatës.


Gjuha e urrejtjes që synon gratë candidate

Të dhënat e monitorimit tregojnë se gratë candidate janë ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në nivele të ndryshme, me dallime të konsiderueshme si në numrin absolut të komenteve me gjuhë të urrejtjes ashtu edhe në përqindjen e tyre në raport me ndërveprimin total.

Natyrë Kuçi ka marrë numrin më të lartë të komenteve me gjuhë të urrejtjes ndër gratë candidate (117 komente). Megjithatë, këto përbëjnë vetëm 2 për qind të gjithsej 5,175 komenteve në 100 postime në rrjetet sociale, çka sugjeron se edhe pse ekspozimi është i lartë në terma absolutë, përqindja e gjuhës së urrejtjes mbetet relativisht e kufizuar në raport me ndërveprimin e përgjithshëm.

Për dallim, Emilija Redžepi ka marrë 17 komente me gjuhë të urrejtjes, që përbëjnë 5 për qind të komenteve totale në vetëm 6 postime. Kjo tregon një përqendrim më të lartë të gjuhës së urrejtjes për postim, duke sinjalizuar një targetim më të shprehur pavarësisht dukshmërisë më të ulët të përgjithshme.

Figura 5. Kandidatet me më së shumti komente me gjuhë të urrejtjes (13 shtator – 10 tetor 2025)



Gratë e tjera kandidate, si Egzona Tërdevci (8 komente; 2%), Jona Arifi (2 komente; 4%) dhe Albulena Balaj-Halimaj (3 komente; 1%), janë përballur me nivele më të ulëta të gjuhës së urrejtjes, si në terma absolutë ashtu edhe proporcionalë.

Vlen të theksohet se Besa Shahini, pavarësisht dukshmërisë shumë të lartë (114 postime dhe 1,521 komente), ka marrë vetëm një koment me gjuhë të urrejtjes, çka tregon një nivel minimal të targetimit armiqësor në raport me ekspozimin e saj.

Përveç kësaj, fushata elektorale e Shahinit ka qenë kryesisht jo-polarizuese dhe e fokusuar në çështje sociale, dhe jo në narrativa konfrontuese ose identitare. Një profil i tillë fushate mund të ketë ulur nxitjet për mobilizim armiqësor online, pasi polarizimi shpesh është një nga nxitësit kryesorë të gjuhës së urrejtjes dhe të sulmeve të koordinuara.

Një faktor tjetër që mund të ketë ndikuar është perceptimi i pozicionit të Shahinit në garën elektorale. Ndryshe nga burrat që ishin kandidatë kryesorë, ajo nuk është paraqitur gjerësisht si një kërcënim i drejtpërdrejtë për perspektivat elektorale të kandidatëve favoritë. Si rezultat, kandidatura e saj mund të ketë tërhequr më pak armiqësi strategjike ose instrumentale nga rrjete partiake që synojnë të dëmtojnë kandidatët rivalë. Në tërësi, këta faktorë sugjerojnë se si stili i fushatës ashtu edhe perceptimi për konkurrueshmërinë elektorale luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e ekspozimit ndaj urrejtjes online, krahas dimensionit gjinor.

Gjuha e urrejtjes në garat e monitoruara komunale

Në komunat e monitoruara, nivelet e gjuhës së urrejtjes janë dukshëm më të larta në terma absolutë, veçanërisht në garat për kryetar komune që karakterizohen nga konkurrencë e fortë dhe ndërveprim i lartë online.

Në Prishtinë, të gjithë kandidatët kryesorë janë përballur me vëllime shumë të larta të gjuhës së urrejtjes, duke reflektuar intensitetin e garës elektorale.

- *Përparim Rama ka marrë 2,342 komente me gjuhë të urrejtjes (7%) nga gjithsej 31,788 komente.*
- *Hajrulla Çeku pason me 1,132 komente (7%),*
- *ndërsa Uran Ismaili ka marrë 488 komente të tilla (4%).*

Në Mitrovicën e Jugut, Faton Peci dallohet me 2,122 komente me gjuhë të urrejtjes, që përbëjnë 9% të të gjitha komenteve, përqindja më e lartë ndër kandidatët me dukshmëri të lartë, çka tregon një mjedis online veçanërisht armiqësor. Arian Tahiri paraqet një shkallë shumë më të ulët proporcionale (2%), pavarësisht ndërveprimit të konsiderueshëm.

Në Gjakovë, nivelet e gjuhës së urrejtjes janë mesatare, por relativisht të qëndrueshme ndër kandidatët kryesorë. Ardian Gjini dhe Ardian Gola kanë marrë secili nga 6% të komenteve të identifikuar si gjuhë urrejtjeje, duke sugjeruar një nivel relativisht të normalizuar të diskursit armiqësor.

Në Prizren, modelet janë të përziera. Ndërsa kandidatë si Artan Abrashi përballen me një përqindje më të lartë (5%), kandidatë të tjerë, pavarësisht ndërveprimit të lartë, kanë shënuar nivele shumë më të ulëta, gjë që tregon se ka pasur targetim specifik ndaj kandidatëve dhe jo medoemos një trend të përgjithshëm në nivel komune.

Në Mitrovicën e Veriut, numrat absolutë janë më të ulët, por intensiteti proporcional mund të jetë i lartë. Në rastin e Milan Radojević, 16% e komenteve janë identifikuar si gjuhë urrejtjeje, duke dalë si përqindja më e lartë në tërësinë e të dhënave të analizës, pavarësisht ndërveprimit të përgjithshëm relativisht të kufizuar. Kjo tregon një mjedis digital shumë të polarizuar dhe armiqësor, edhe në kontekste me audienca relativisht të vogla.

Në tërësi, gjetjet tregojnë se gjuha e urrejtjes lidhet ngushtë me rëndësinë politike dhe nivelin e polarizimit të garës, dhe jo vetëm me vëllimin e aktivitetit online. Ndërsa garat me profil të lartë gjenerojnë më shumë gjuhë urrejtjeje në terma absolutë, kontekstet më të vogla ose më të polarizuara mund të prodhojnë nivele shumë më të larta proporcionale, duke rritur ndikimin mbi kandidatët.

1.3 Përfundime

Gjetjet tregojnë se mbulimi mediatik i grave kandidate për kryetare komunash në zgjedhjet lokale të vitit 2025 është i pabarabartë, shumë i politizuar dhe i kufizuar në mënyrë strukturore, ku dukshmëria formësohet më shumë nga dinamika politike kombëtare dhe temat polarizuese sesa nga agjendat lokale të kandidateve apo kapacitetet e tyre për qeverisje. Në komunat e analizuara, gratë kandidate shpesh paraqiten në kuadër të konflikteve më të gjera politike, si çështjet e sigurisë, marrëdhëniet ndëretnike apo tema të rëndësishme në nivel kombëtar, dhe më rrallë përmes diskutimeve thelbësore mbi udhëheqjen komunale, propozimet në nivel politikash apo ofrimin e shërbimeve publike. Ky model rrezikon të shtrembërojë perceptimet e votuesve dhe të kufizojë zgjedhjen elektorale të informuar, duke filtruar pjesëmarrjen politike të grave përmes këndvështrimeve që shpesh janë të shkëputura nga realitetet e qeverisjes lokale.

Mjediset mediatike në komunat e analizuara shfaqin forma të ndryshme, por të qëndrueshme, të polarizimit dhe të përqendrimit të vëmendjes, duke favorizuar zakonisht një ose dy kandidatë kryesorë dhe duke marginalizuar të tjerët. Në garat me dukshmëri të lartë, si në Prishtinë dhe Mitrovicën e Jugut, narrativat mediatike dominohen nga temat e investimeve, sigurisë ose politikës kombëtare, duke ngushtuar hapësirën e debatit dhe duke reduktuar mundësinë për paraqitjen e perspektivave alternative të politikave. Në kontekste të tjera, si në Prizren, Gjakovë, Mitrovicën e Veriut dhe Graçanicë, mbulimi mbetet gjithashtu i kufizuar, qoftë i përqendruar në një kandidat të vetëm ose i kufizuar në një numër të vogël temash, duke kufizuar pluralizmin dhe duke shtypur diskutimin mbi politikat sociale, shërbimet publike dhe planifikimin afatgjatë komunal.

Gjetjet tregojnë gjithashtu se gjuha e urrejtjes që synon gratë kandidate nuk lidhet drejtpërdrejt me nivelin e dukshmërisë. Në disa raste, gratë me ekspozim më të ulët mediatik janë përballur me një përqindje disproporcionale të përmbajtjes armiqësore ose diskriminuese, gjë që sugjeron targetim të qëllimshëm dhe jo thjesht një pasojë të

vëmendjes publike. Kjo thekson kufizimet e vlerësimeve të bazuara vetëm në dukshmëri dhe nënvizon nevojën për monitorim të përgjegjshëm gjinor në nivel kandidati, i cili mund të identifikojë targetimin armiqësor edhe në mjedise mediatike me vëllim të ulët raportimi. Në tërësi, gjetjet nxjerrin në pah ekzistencën e paragjykimeve strukturore në mbulimin mediatik që ndikojnë si në dukshmërinë politike ashtu edhe në cenueshmërinë e kandidatëve, me implikime të rëndësishme për barazinë gjinore, pluralizmin mediatik dhe cilësinë e konkurrencës demokratike në nivel lokal.

Përveç dallimeve në nivelin e ekspozimit, gjetjet shpërfaqin edhe modele gjinore në natyrën e gjuhës së urrejtjes që synon kandidatët. Gratë kandidate janë më shpesh të ekspozuara ndaj formave të personalizuar dhe të bazuara në identitet të armiqësisë, përfshirë fyerje me bazë gjinore, delegitimim të kompetencës dhe sulme që lidhen me pamjen fizike, moralin apo rolet e perceptuara shoqërore. Këto shprehje, edhe kur nuk janë të shumta në terma absolutë, kanë tendencë të jenë më të synuara dhe diskriminuese, duke përforcuar stereotipat strukturorë për pjesëmarrjen e grave në politikë. Për dallim, gjuha e urrejtjes që drejtohet ndaj burrave kandidatë është kryesisht e natyrës politike, duke u fokusuar në përkatësinë partiake, qëndrimet politike, akuzat për korrupsion apo punën e kryer, dhe më shpesh është e integruar në përplasje më të gjera partiake ose ideologjike sesa në identitetin personal.

Ky dallim është i rëndësishëm, pasi gjuha e urrejtjes me bazë gjinore ka një ndikim cilësisht të ndryshëm nga armiqësia e përgjithshme politike. Ndërsa sulmet politike janë një element i pritshëm në mjediset konkurruese elektorale, abuzimi i bazuar në gjini dhe identitet synon të vërë në dyshim legjitimitetin e grave si aktore politike dhe mund të ketë efekt më të fortë frenues në pjesëmarrjen politike. Prandaj, gjetjet sugjerojnë se gratë kandidate jo vetëm që përballen me nivele të ndryshme armiqësie, por edhe me forma të ndryshme të gjuhës së urrejtjes, duke theksuar nevojën për mekanizma monitorimi dhe përgjigje në nivel politikash që bëjnë dallimin ndërmjet kritikës politike dhe abuzimit me bazë gjinore.


2. Monitorimi manual i pranisë online të aktorëve politikë

Kjo pjesë paraqet rezultatet e monitorimit manual të llogarive të partive politike dhe kandidatëve në platformat e përzgjedhura digjitale gjatë periudhës së fushatës elektorale. Procesi i monitorimit u fokusua në ndjekjen dhe dokumentimin sistematik të përmbajtjes së publikuar nga aktorët politikë, me vëmendje të veçantë ndaj tonit, gjuhës dhe elementeve vizuale të përdorura në komunikimin online. Të dhënat pasqyrojnë vrojtime të përditshme të regjistruara gjatë gjithë periudhës së fushatës dhe evidentojnë rastet kur mesazhet politike ndërthuren me narrativa që lidhen me çështje gjinore.

Gjetjet bazohen në përmbajtje të verifikuara të marrë nga llogaritë zyrtare të partive dhe kandidatëve dhe janë të organizuara përmes paneleve të monitorimit specifike për secilën komunë. Këto panele dokumentojnë rastet e identifikuara të përmbajtjes diskriminuese, poshtëruese ose seksiste, përfshirë gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore dhe stereotipa të dëmshëm që synojnë gratë, dhe mbështeten në pamje të arkivuara të ekranit që tregojnë datën, kohën, burimin dhe platformën. Rezultatet e paraqitura në këtë pjesë synojnë të përshkruajnë shtrirjen, shpeshtësinë dhe shpërndarjen e përmbajtjes së vërtetuar nëpër platforma, pa nxjerrë përfundime ose gjykime vlerësuese në këtë fazë. Interpretimi dhe analiza kontekstuale e këtyre gjetjeve trajtohen në pjesën pasuese.

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të pabarabartë të rasteve të identifikuara të përmbajtjes diskriminuese, seksiste ose me stereotipa gjinorë në komunat e monitoruara.

Figura 6. Identifikimi i rasteve në nivel komune.



Në total janë regjistruar 117 raste, me dallime të dukshme si në intensitet ashtu edhe në përqendrimin gjeografik. Prizreni përbën numrin më të lartë të rasteve të identifikuar (54 raste), duke përfaqësuar pothuajse gjysmën e të gjitha incidenteve të shënuara. Kjo sugjeron një nivel më të lartë të aktivitetit të fushatës digjitale, si dhe një prani më të theksuar të përmbajtjes problematike që lidhet me gjuhën gjinore dhe stereotipat që synojnë gratë.

Prishtina, si qendra kryesore politike dhe mediatike, renditet e dyta me 32 raste të identifikuar. Kjo është në përputhje me vëllimin më të lartë të komunikimit politik dhe të angazhimit publik në platformat digjitale, ku dukshmëria dhe ndërveprimi kanë tendencë të kenë natyrë më intensive.

Gjakova dhe Mitrovica e Veriut kanë shënuar nga 12 raste secila, duke treguar një prani mesatare të këtij lloji të përmbajtjes. Për dallim, Mitrovica e Jugut ka shënuar një numër më të ulët rastesh (7 raste), gjë që mund të reflektojë një nivel më të kufizuar të aktivitetit online nga kandidatët ose praktika më të përmbajtura të komunikimit.

Vlen të theksohet se Graçanica nuk ka shënuar asnjë rast të identifikuar gjatë periudhës së monitorimit. Kjo mund të tregojë ose një nivel të ulët të aktivitetit të fushatës digjitale ose mungesën e përmbajtjes që plotëson kriteret e identifikimit të përcaktuara në metodologjinë e monitorimit.

Shpërndarja kohore e shkeljeve të raportuara tregon se sjellja e dëmshme online nuk ishte e kufizuar vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës, por ishte e pranishme dhe e theksuar edhe në javët që i paraprinë asaj. Pjesa më e madhe e shkeljeve është shënuar dy javë para fillimit zyrtar të fushatës elektorale, duke përbërë 37% të të gjitha rasteve të raportuara. Kjo sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes problematike është shfaqur gjatë fazës së para-fushatës, kur komunikimi politik dhe pozicionimi publik po intensifikoheshin, ndërsa rregullat formale të fushatës mund të jenë zbatuar më dobët.

Gjatë javës që i parapriu menjëherë fillimit të fushatës, shkeljet e raportuara ranë ndjeshëm në 11%, duke treguar një rënie të përkohshme të incidenteve të regjistruara. Pas fillimit zyrtar të fushatës, numri i shkeljeve është luhatur gjatë gjithë periudhës së saj dhe shkeljet nuk kanë ndjekur një trend linear. Java e parë e fushatës përbën 14% të rasteve, e ndjekur nga një rënie në javën e dytë (9%) dhe një rritje e mëvonshme në javën e tretë (12%).

Java e fundit e fushatës elektorale shënoi një rritje të re të shkeljeve, duke përfaqësuar 17% të totalit. Kjo rritje ka gjasa të reflektojë intensifikimin e konkurrencës politike, shtimin e mesazheve të fushatës dhe mobilizimin më të madh emocional të elektoratit me afrimin e ditës së zgjedhjeve.

Shpërndarja e shkeljeve të identifikuar sipas partive politike shpërfaq një model shumë të pabarabartë në shfaqjen e përmbajtjes diskriminuese, seksiste ose me stereotipa gjinorë gjatë periudhës së monitorimit. Në total janë identifikuar 117 raste.

Lëvizja Vetëvendosje (VV) përbën pjesën më të madhe të rasteve të identifikuar, me 77 incidente, që përfaqësojnë rreth 65.8% të të gjitha shkeljeve të regjistruara. Ky përqendrim i theksuar tregon se pothuajse dy të tretat e shkeljeve të monitoruara që lidhen me çështje gjinore janë të lidhura me llogari të partisë ose të kandidatëve të lidhur me VV-në.

Kategoria e aktorëve politikë “Të tjerë” përfshin 18 raste, që përbëjnë 15.4% të totalit. Kjo sugjeron se, megjithëse shumica e incidenteve lidhen me aktorët kryesorë politikë, një pjesë e konsiderueshme e tyre buron edhe nga parti më të vogla, kandidatë të pavarur ose aktorë që nuk janë të kategorizuar nën partitë kryesore.


Alternativa ka shënuar 7 raste (6.0%), ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë shënuar nga 5 raste secila, që përfaqësojnë 4.3% për secilën parti. Guxo ka shënuar 3 raste (2.6%), ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shënuar 2 raste, ose 1.7% të totalit.

Shpërndarja e rasteve sipas partive politike të targetuara tregon një përqendrim të përmbajtjes diskriminuuese ndaj një numri të kufizuar aktorësh politikë. Nga gjithsej 117 raste të identifikuar, targetimi është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë ndërmjet partive politike dhe aktorëve të tjerë politikë.

Pjesa më e madhe e rasteve bie në kategorinë “Të tjerë”, me 33 raste, që përbëjnë rreth 28.2% të totalit. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes abuzive ka synuar figura ose aktorë politikë jashtë partive kryesore parlamentare, përfshirë parti më të vogla, kandidatë të pavarur ose aktorë që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me ndonjë parti politike.

Ndër partitë kryesore politike, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë më së shpeshti e vënë në shënjestër, me 31 raste, që përfaqësojnë 26.5% të të gjitha rasteve të identifikuar. Pas saj renditet Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17 raste (14.5%) dhe Lëvizja Vetëvendosje (VV) me 15 raste (12.8%).

Figura 7. Shkeljet e raportuara sipas periudhës kohore.



Nivele më të ulëta të targetimit janë regjistruar për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 3 raste (2.6%), Listën Serbe me 2 raste (1.7%) dhe Guxo me 1 rast (0.9%). Alternativa nuk është vënë në shënjestër në asnjë nga rastet e identifikuar.


Gjithashtu, 15 raste (12.8%) kanë përfshirë objektiva jashtë partive politike, si figura publike ose aktorë që nuk janë të lidhur formalisht me ndonjë organizatë politike.

Shpërndarja e shkeljeve të regjistruara sipas platformave të mediave sociale tregon një përqendrim shumë të theksuar në një platformë të vetme, ndërsa incidenca në platformat e tjera është dukshëm më e ulët. Nga gjithsej 117 raste të identifikuar, shumica dërrmuese janë regjistruar në Facebook, me 110 raste, që përbëjnë rreth 94% të të gjitha shkeljeve të identifikuar.

Ky dominim reflekton rolin e Facebook-ut si platforma kryesore për fushata politike dhe ndërveprim publik gjatë periudhës elektorale. Niveli i lartë i angazhimit të përdoruesve, përdorimi i gjerë nga partitë politike dhe kandidatët, si dhe seksionet interaktive të komenteve krijojnë ekspozim më të madh ndaj gjuhës me ngjyrime gjinore, shprehjeve diskriminuese dhe stereotipave të dëmshëm.

Për dallim, në TikTok janë shënuar 6 raste (rreth 5% të totalit). Megjithatë TikTok po bëhet gjithnjë e më me ndikim, veçanërisht tek audiencat më të reja, numri më i ulët i shkeljeve të identifikuar mund të lidhet me dallimet në formatin e përmbajtjes, praktikat e moderimit ose strategjitë e fushatës që mbështeten më shumë në video të shkurtra sesa në ndërveprim të drejtpërdrejtë tekstual.

Figura 8. Partitë politike me numrin më të lartë të shkeljeve.



Vetëm 1 rast (më pak se 1%) është identifikuar në Instagram, gjë që sugjeron një prani të kufizuar të përmbajtjes që plotëson kriteret e monitorimit, mbase për shkak të stilit më të kurrar dhe kryesisht vizual të komunikimit në këtë platformë.


Vlen të theksohet se gjatë periudhës së monitorimit nuk është regjistruar asnjë shkelje në X (ish-Twitter). Kjo mund të tregojë nivele më të ulëta të aktivitetit të lidhur me fushatën nga aktorët e monitoruar në këtë platformë ose dallime në ndërveprimin e audiencës dhe dinamikat e përmbajtjes në kontekstin elektorale të Kosovës.

Analiza e postimeve online të publikuara nga kandidatët për kuvende komunale dhe për pozita të kryetarëve të komunave në gjashtë komunat e monitoruara tregon një dominim të qartë të gjuhës së urrejtjes si forma më e shpeshtë e shkeljeve. Nga gjithsej 117 raste të identifikuara, gjuha e urrejtjes përbën 82 raste (70.1%), duke treguar se gjuha diskriminuese dhe armiqësore është forma kryesore e komunikimit politik të dëmshëm online gjatë periudhës së fushatës.

Ngacmimi dhe bullizmi personal përbëjnë kategorinë e dytë më të shpeshtë të shkeljeve, me 18 raste (15.4%). Këto raste zakonisht përfshijnë sulme të drejtpërdrejta ndaj individëve, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi toksik online dhe duke cenuar standardet e debatit politik të respektueshëm.

Dezinformimi është identifikuar në 10 raste (8.5%), çka tregon se megjithëse përmbajtja e rreme ose lajthitëse është e pranishme, ajo është më pak e përhapur sesa gjuha hapur armiqësore. Megjithatë, edhe një numër i kufizuar rastesh të dezinformimit mund të ketë ndikim disproporcional në perceptimet e votuesve dhe në besimin në procesin elektorale.

Figura 9. Partitë politike më të targetuara



Vetëm 0.9% e rasteve kanë përfshirë thirrje për dhunë, çka tregon se nxitja e drejtpërdrejtë për dëmtim fizik është e rrallë në përmbajtjen e monitoruar. Megjithatë, prania e edhe një rasti të tillë mbetet shqetësuese për shkak të potencialit për të përshkallëzuar tensionet dhe për të legjitimuar sjellje agresive.


Kategoria “Të tjera”, që përfshin 6 raste (5.1%), përmbledh shkelje që nuk përfshihen qartë në kategoritë kryesore, por që gjithsesi bien ndesh me standardet e komunikimit politik etik dhe përfshirës.

2.1 Përfundime

Gjetjet tregojnë se shkeljet online dhe përmbajtja diskriminuese me bazë gjinore në komunikimin politik formësohen nga dinamika elektorale dhe nga kushtet specifike të platformave digjitale, dhe nuk shfaqen në mënyrë të rastësishme apo të shpërndarë njëtrajtshëm në kohë, hapësirë dhe ndërmjet aktorëve. Armiqësia online ka tendencë të intensifikohet gjatë periudhave të tensionit të lartë politik, veçanërisht në fazën para-fushatës dhe në ditët e fundit të garave elektorale, duke nënvizuar nevojën që monitorimi dhe masat parandaluese të shtrihen përtej periudhës formale të fushatës. Këto modele kohore sugjerojnë se mekanizmat e paralajmërimit të hershëm dhe reagimit të shpejtë janë thelbësorë për të zbutur dëmet para se shkeljet të përshkallëzohen.

Analiza tregon gjithashtu se përmbajtja diskriminuese me bazë gjinore është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, duke u përqendruar në komuna me nivele më të larta të aktivitetit politik dhe angazhimit digjital, si dhe rreth aktorëve me dukshmëri të

Figura 10. Përqindja e shkeljeve sipas platformës së mediave sociale



lartë ose rëndësi të veçantë politike. Megjithatë shumica e rasteve të identifikuar kanë vënë në shënjestër një numër të kufizuar aktorësh dhe partish politike, këto modele duhet të interpretohen në raport me intensitetin e përgjithshëm të fushatës, praninë online dhe vëllimin e përmbajtjes së publikuar. Numrat absolutë nuk e pasqyrojnë plotësisht situatën dhe kërkojnë vlerësim cilësor për të kuptuar natyrën, seriozitetin dhe qëllimin e shkeljeve.


Analiza sipas platformave tregon se Facebook-u mbetet hapësira kryesore ku shfaqet përmbajtja politike diskriminuese dhe seksiste me bazë gjinore, duke konfirmuar rolin qendror të kësaj platforme në formësimin e diskursit elektoral dhe perceptimit publik. Kjo gjetje thekson rëndësinë e dhënies së prioritetit për monitorimin dhe masat parandaluese të përqendruara në Facebook, duke ruajtur njëkohësisht vigjilencën ndaj trendeve në zhvillim në platformat e tjera, veçanërisht në TikTok.

Së fundi, të dhënat sugjerojnë se sjellja e dëmshme online shprehet më shpesh përmes retorikës së normalizuar armiqësore dhe diskriminuese sesa përmes nxitjes së hapur për dhunë ose dezinformimit të koordinuar. Së këndejmi, adresimi i këtyre formave të përditshme të abuzimit është thelbësor, pasi ndikimi i tyre kumulativ kontribuon në normalizimin e diskursit politik përjashtues dhe paraqet rreziqe afatgjata për pjesëmarrjen përfshirëse dhe për cilësinë e demokracisë.

3. Përvojat e grave në nivel kombëtar

Për të plotësuar monitorimin sasior të gjuhës së urrejtjes online, kjo pjesë paraqet gjetjet nga intervistat e thelluara me tetë gra kandidate në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Intervistat ofrojnë një perspektivë cilësore për të kuptuar se si gratë në politikë e

Figura 11. Përqindja e shkeljeve të raportuara sipas llojit të shkeljes



përfshijnë abuzimin online dhe si ai ndikon në pjesëmarrjen, dukshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre gjatë fushatave elektorale.

Intervistat janë strukturuar rreth pesë fushave kryesore tematike: (i) ndikimi emocional dhe personal, që shqyrton se si gjuha e urrejtjes ka ndikuar në mirëqenien e kandidateve, në familjet e tyre dhe në motivimin për angazhim politik; (ii) mekanizmat e mbështetjes, duke përfshirë rolin e partive politike, kolegëve, familjeve dhe mjeteve të raportimit; (iii) ndikimi politik dhe ai që lidhet me zhvillimin e fushatës, që vlerëson nëse abuzimi online ka ndikuar në rezultatet elektorale, në strategjitë e fushatës ose në angazhimin publik; (iv) targetimi me bazë gjinore, i fokusuar në narrativat seksiste, sulmet personale dhe ngacmimin që lidhet me çështjet për të cilat angazhohen gratë në politikë; dhe (v) reflektimet dhe rekomandimet, që pasqyrojnë perspektivat e kandidateve për masat mbrojtëse të nevojshme dhe për reagimet institucionale që duhet të forcohen.

Në tërësi, këto gjetje e përkthejnë të dhënat e monitorimit në përvoja konkrete jetësore, duke theksuar si strategjitë individuale të përballimit ashtu edhe boshllëqet strukturore që vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave në jetën politike.

3.1 Ndikimi emocional dhe personal

Presioni kumulativ emocional dhe psikologjik

Të intervistuarat e përshkruan në mënyrë të vazhdueshme gjuhën e urrejtjes online si një formë presioni të vazhdueshëm dhe kumulativ, dhe jo si një sërë incidentesh të izoluara. Kjo lidhet me arkitekturën e platformave digjitale, ku përmbajtja abuzive mund

“Pavarësisht të gjithave, mesazhi im është të mos dorëzohemi. Politika ka nevojë për gra dhe ndryshimi ndodh vetëm kur gratë vazhdojnë të angazhohen, edhe kur kostoja është e lartë.”

të amplifikohet lehtësisht, të riprodhohet dhe të mbetet e pranishme për periudha të gjata kohore. Ndërsa armiqësia politike ka qenë prej kohësh pjesë e konkurrencës elektorale, kandidatet theksuan se digjitalizimi e ka shndërruar gjuhën e urrejtjes në një mekanizëm të shkallëzueshëm dhe të vazhdueshëm të dhunës ndaj grave në politikë, i cili mund të arrijë menjëherë audienca të gjera dhe të mbetet i aksesueshëm edhe shumë kohë pas sulmit fillestar. Si rezultat, krijohet një presion emocional i zgjatur, i karakterizuar nga stresi, lodhja emocionale dhe ulja e

kapaciteteve gjatë periudhave të fushatës.

Ndërhyrja në jetën private dhe familjare

Një karakteristikë përcaktuese e dëmit të përshkruar është shtrirja e abuzimit në sferën private dhe familjare të kandidateve. Të intervistuarat raportuan se sulmet shpesh synonin prindërit, fëmijët dhe partnerët e tyre, duke shkaktuar shqetësim emocional jo vetëm për vetë kandidatet, por edhe për njerëzit më të afërt të tyre. Kjo shtrirje përbën një taktikë qartësisht të lidhur me gjininë, e cila shfrytëzon pritjet shoqërore për rolin e grave si ofruese të kujdesit dhe amplifikon ndjenjat e fajit, frikës dhe përgjegjësisë. Për shumë

kandidate, shqetësimi për mirëqenien e familjes e rriti ndikimin emocional më shumë sesa sulmet e drejtuara drejtpërdrejt ndaj tyre.

Efektet frenuese dhe disiplinuese në pjesëmarrjen e grave

Përtej dëmit të drejtpërdrejtë emocional, kandidatet identifikuan efektin frenues si një nga pasojat më të dëmshme të gjuhës së urrejtjes online. Të intervistuarat theksuan vazhdimisht se dëmi kryesor qëndron në ndikimin që kjo dukuri ka në gratë dhe vajzat e tjera, veçanërisht ato që po mendojnë të hyjnë në politikë për herë të parë. Disa prej tyre raportuan vështirësi konkrete në rekrutimin e grave kandidate, sidomos në nivel lokal, duke përmendur frikën nga ekspozimi publik, sulmet mizogjene dhe dëmtimin e reputacionit. Në këtë kuptim, gjuha e urrejtjes online funksionon si një mekanizëm disiplinues, duke sinjalizuar se pjesëmarrja politike për gratë shoqërohet me një kosto të lartë personale dhe shoqërore.

“Po, është e vështirë dhe po, ka momente kur e pyet veten nëse ia vlen. Por kur shikon pas, çdo sfidë ia ka vlejtur.”

Presioni për tërheqje dhe lodhja emocionale

Intervistat nxjerrin në pah se gjuha e urrejtjes online shpesh krijon presion për tërheqje nga angazhimi politik, edhe kur kandidatet në fund vendosin të vazhdojnë aktivitetin e tyre politik. Është domethënëse që ideja e tërheqjes shpesh është ngritur nga anëtarët e familjes dhe jo nga vetë kandidatet, çka reflekton fuqinë indirekte të dhunës ndaj grave në politikë. Periudhat e abuzimit të intensifikuar, veçanërisht kur shoqëroheshin me kërcënime, frikësim, dezinformim ose amplifikim nga mediat tradicionale, vendosnin familjet nën presion të konsiderueshëm emocional, duke çuar ndonjëherë në kërkesa të drejtpërdrejta që kandidatet të shqyrtonin mundësinë e tërheqjes për arsye sigurie.

Një numër më i vogël i grave të intervistuarat raportuan se kishin konsideruar seriozisht tërheqjen pas ekspozimit të vazhdueshëm ndaj abuzimit, përfshirë kërcënime që përfshinin adresat personale, ngacmime jashtë hapësirës online dhe fushata të koordinuara dezinformimi. Këto përvoja ilustronë se si gjuha e urrejtjes online mund të kalojë në presion, duke e zbehur kufirin ndërmjet armiqësisë politike dhe dhunës politike, dhe duke u përputhur me një nga objektivat kryesore të dhunës ndaj grave në politikë: heshtjen ose largimin e grave nga hapësira politike.

Qëndrueshmëria, kapacitetet e pabarabarta dhe normalizimi i dëmit

Megjithëse shumë kandidate e përshkruan vazhdimin e angazhimit të tyre si një akt rezistence, kjo qëndrueshmëri nuk duhet të interpretohet si mungesë e dëmit. Të intervistuarat paralajmëruan vazhdimisht se aftësia e tyre për t'u përballur me këtë situatë reflekton kapacitete të pabarabarta, të formësuara nga përvoja politike, pozicioni institucional dhe aksesit në mbështetje familjare ose partiake. Gratë më të reja, kandidatet për herë të parë dhe ato që nuk kanë struktura të forta mbështetëse u identifikuan si veçanërisht të cenueshme. Disa kandidate përshkruan distancimin emocional ose mpirjen emocionale si strategji përballimi, të cilat mund të ndihmojnë mbijetesën

individuale, por njëkohësisht sjellin riskun e normalizimit të dhunës ndaj grave në politikë si një element të pashmangshëm të jetës politike.

Ndikimi në diskursin politik dhe cilësinë e demokracisë

Të intervistuarat e lidhën gjithashtu gjuhën e urrejtjes online me një përkeqësim më të gjerë të diskursit politik. Duke zhvendosur debatin nga politikat publike dhe llogaridhënia drejt sulmeve personale, narrativave seksiste dhe stigmatizimit moral, dhuna ndaj grave në politikë minon diskutimin demokratik thelbësor dhe dekurajon ripërtëritjen politike. Disa kandidatë përshkruan fushata të koordinuara që kombinonin abuzimin online me dezinformimin, inkuadrimin nacionalist dhe, në disa raste, edhe përdorimin e teknologjive në zhvillim si inteligjenca artificiale, duke rritur më tej shkallën dhe sofistikimin e sulmeve.

3.2 Mekanizmat mbështetës

Mbështetja familjare si mekanizëm kyç i qëndrueshmërisë

Një gjetje e përbashkët dhe pothuajse universale në intervista është roli qendror i mbështetjes familjare si burimi kryesor i qëndrueshmërisë emocionale dhe psikologjike. Për shumicën e kandidatëve, partnerët, prindërit dhe familjarët e ngushtë kanë funksionuar si një faktor stabilizues dhe si një parakusht për vazhdimin e angazhimit politik, veçanërisht gjatë periudhave të presionit të lartë, sulmeve publike ose kërcënimeve. Disa të intervistuarat deklaruan shprehimisht se pa mbështetjen e familjes, karriera e tyre politike nuk do të kishte qenë e mundur, duke e përshkruar familjen jo vetëm si një rrjet emocional mbështetës, por edhe si një mburojë ndaj dhunës politike.

*“Mos lejoni t’ju dekurajojë
ashpërsia e gjuhës. Kjo
gjuhë menduar për t’i
larguar gratë nga politika.
Qëndrimi aty është tashmë
pjesë e ndryshimit.”*

Në të njëjtën kohë, intervistat nxjerrin në pah një paradoks: ndërsa mbështetja familjare është thelbësore, ekspozimi i anëtarëve të familjes që nuk janë figura publike, veçanërisht i prindërve dhe fëmijëve, përbën një nga dimensionet më të dhimbshme të dhunës ndaj grave në politikë. Sulmet e drejtuar ndaj anëtarëve të familjes rrisin ndjeshëm presionin emocional dhe ndjenjën e fajit, duke përforcuar natyrën gjinore të dhunës politike përmes shfrytëzimit të perceptimit shoqëror se gratë mbajnë përgjegjësi të veçantë për mirëqenien e familjes.

Mbështetja nga partitë: selektive, e paqëndrueshme dhe shpesh e pamjaftueshme

Për dallim nga mbështetja familjare, mbështetja nga partitë politike paraqitet e fragmentuar dhe e paqëndrueshme. Vetëm një numër i vogël i grave të intervistuarat raportuan se kanë marrë mbështetje të qartë institucionale, ndërsa shumica përshkruan mbështetje individuale nga disa kolegë, heshtje nga strukturat partiake ose hezitim të qëllimshëm për të reaguar për shkak të kostove të perceptuara politike.

Një model i rëndësishëm analitik është se partitë kanë më shumë gjasa të reagojnë kur sulmet janë të drejtpërdrejta, personale dhe qartë të identifikueshme, por partitë janë të prira të shmangin angazhimin kur sulmet lidhen me çështje të ndjeshme sociale ose morale, si edukimi seksual, të drejtat e komunitetit LGBTI+ apo barazia gjinore. Në raste të tilla, gratë kandidate shpesh mbeten të izoluara politikisht, ndërsa sulmet riformulohen si “opinion publik” ose “debat shoqëror”, duke i zhveshur ato në mënyrë efektive nga dimensionet e dhunës me bazë gjinore. Në disa raste, mungesa e solidaritetit shkon edhe më tej, kur figura të partisë pozicionohen publikisht kundër kandidates së targetuar, duke përforcuar stigmatizimin dhe duke e paraqitur atë si “kundër familjes”, “ndesh traditës” ose “jashtë normave të pranuar”.

Solidariteti ndërmjet grave si mekanizëm informal mbështetjeje

Një gjetje veçanërisht e rëndësishme lidhet me rolin e solidaritetit horizontal ndërmjet grave në politikë, i cili shpesh kompenson mungesën e mekanizmave formalë të mbështetjes. Disa të intervistuar përshkruan se mbështetja më domethënëse që kanë marrë ka ardhur nga gra të tjera që kanë përjetuar sulme të ngjashme, përmes bisedave informale, kontakteve personale dhe ndarjes së strategjive për përballimin e situatave të vështira.

Ky solidaritet ofron mbështetje emocionale, legjitimon përvojat e dhunës dhe ndihmon gratë të zhvillojnë strategji psikologjike të vetëmenaxhimit. Megjithatë, ai mbetet informal, i personalizuar dhe i varur nga rrjetet individuale. Për këtë arsye, ai nuk mund të garantojë mbrojtje sistematike ose të zëvendësojë përgjegjësinë institucionale, dhe rrezikon të mbingarkojë gratë me detyrën për të mbështetur njëra-tjetrën në mungesë të mekanizmave formalë mbrojtës.

Raportimi i abuzimit: përdorim selektiv dhe i kushtëzuar i mekanizmave formalë

Intervistat tregojnë se gratë kandidate i përdorin mekanizmat formalë të raportimit në mënyrë selektive dhe të kushtëzuar. Vërehet një dallim i qartë ndërmjet fyerjeve dhe gjuhës së urrejtjes, të cilat shpesh normalizohen, injorohen ose menaxhohen përmes bllokimit në rrjetet sociale, dhe kërcënimeve serioze, të cilat kanë më shumë gjasa të rezultojnë në kallëzime penale ose padi civile.

Mjetet që përdoren më shpesh përfshijnë raportimin dhe bllokimin në platformat e mediave sociale, paraqitjen e kallëzimeve penale në polici, iniciimin e padive për shpifje ose për gjuhë urrejtjeje, si dhe paraqitjen e ankesave pranë organeve rregullatore të mediave. Në disa raste përdoren edhe platformat e shoqërisë civile. Megjithatë, një gjetje kritike është se reagimet gjyqësore dhe institucionale shpesh janë të ngadalta, të paqëndrueshme ose selektive, duke gjeneruar frustrim dhe mosbesim. Disa të intervistuar raportuan se veprimet përkatëse janë ndërmarrë vetëm pas presionit publik ose pas ndjekjes së vazhdueshme personale të rastit, ndërsa raste të tjera janë mbyllur pa një vlerësim të plotë, edhe kur ekzistonin indikacione të besueshme për manipulim ose shpifje.

Normalizimi i dhunës dhe vetëmenaxhimi si strategji mbijetese

Disa të intervistuar raportuan se me kalimin e kohës kanë zhvilluar strategji personale përballimi dhe distancimi emocional, duke e interpretuar abuzimin online si pasqyrim

“Përgatituni, edukohuni dhe besoni në vlerat tuaja. Hyni në politikë me njohuri, guxim dhe qartësi për arsyen pse jeni aty.”

të injorancës ose mungesës së edukimit të autorëve. Ndërsa këto strategji mundësojnë vazhdimin e angazhimit politik, ato gjithashtu kontribuojnë në normalizimin e dhunës si një kosto të pashmangshme të pjesëmarrjes në jetën politike. Kjo sjell riskun e rrënjosjes së dhunës ndaj grave në politikë në nivel strukturor, duke zhvendosur përgjegjësinë për menaxhimin e dëmit nga institucionet te vetë gratë.

3.3 Ndikimi politik dhe ai që lidhet me zhvillimin e fushatës

Ndikimi elektoral i gjuhës së urrejtjes

Intervistat tregojnë se ndikimi elektoral i gjuhës së urrejtjes ndaj grave kandidate është i përzier dhe i varur nga konteksti, pa një model të vetëm që zbatohet në të gjitha rastet. Disa kandidate e perceptojnë gjuhën e urrejtjes si faktor që ka shkaktuar dëm relativ elektoral, veçanërisht në rastet kur përqindja e votave të tyre ka mbetur e pandryshuar pavarësisht rritjes së dukshmërisë ose mbajtjes së pozicioneve të larta politike. Në këto raste, fushatat e urrejtjes interpretohen si strategji të qëllimshme për të ulur kredibilitetin politik, për të trivializuar punën profesionale dhe për të mobilizuar narrativa të ndjeshme shoqërore me qëllim minimin e besimit publik. Kandidatet theksojnë se ndikime të tilla shpesh bëhen të dukshme vetëm kur krahasohen me rritjen më të gjerë të partisë, dhe jo medoemos përmes humbjes absolute të votave.

Nga ana tjetër, disa të intervistuar raportojnë rritje të konsiderueshme të mbështetjes elektorale, përfshirë rritje të ndjeshme krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. Këto kandidate e refuzojnë idenë se gjuha e urrejtjes ka ulur atraktivitetin e tyre elektoral dhe rezultatet ua atribuojnë qëndrueshmërisë, kompetencës dhe besimit afatgjatë të votuesve. Megjithatë, edhe ato që kanë përjetuar rritje elektorale, pranojnë se ndikimi i vërtetë i gjuhës së urrejtjes nuk mund të matet plotësisht. Kandidatet pranojnë mundësinë që disa votues të jenë dekurajuar nga diskursi armiqësor, ndërsa të tjerë mund të jenë mobilizuar falë empatisë ose solidaritetit. Kjo tregon se rritja elektorale nuk e përjashton ekzistencën e dëmit, por mund të fshehë efekte të kundërta që veprojnë njëkohësisht.

Ndikimi në strategjinë dhe zhvillimin e fushatës

Për sa i përket strategjisë së fushatës, shumica e kandidateve nuk raportuan ndryshime thelbësore në mesazhet politike ose në pozicionimin e tyre. Megjithatë, intervistat nxjerrin në pah përshtatje në sjellje dhe në aspektin operacional për të menaxhuar presionin e krijuar nga gjuha e urrejtjes. Një strategji e zakonshme ka qenë kufizimi i ekspozimit ndaj komenteve online, veçanërisht gjatë periudhave shumë të polarizuara, me qëllim mbrojtjen e mirëqenies emocionale dhe ruajtjen e kapacitetit për fushatë. Kjo formë vetërregullimi nuk paraqitet si shmangie, por si një domosdoshmëri praktike për të ruajtur fokusin dhe efektivitetin.

“Mos e komprometoni integritetin tuaj personal ose profesional për t’iu përshtatur pritjeve. Politika ka nevojë për autenticitet, jo për bindje të verbër.”

Disa kandidate përshkruan gjithashtu nevojën për moderim aktiv të hapësirave online, përfshirë fshirjen e komenteve fyese, bllokimin ose raportimin e llogarive abuzive dhe mbështetjen në ekipet e fushatës për menaxhimin e platformave digjitale. Këto praktika tregojnë se gjuha e urrejtjes krijon një ngarkesë shtesë pune, shpesh të padukshme, për kandidatët dhe ekipet e tyre. Disa të intervistuar theksuan gjithashtu se sulmet e vazhdueshme krijojnë presion për të shfaqur më shumë vetëbesim dhe qëndrueshmëri në paraqitjet publike, jo si ndryshim në përmbajtjen e mesazhit politik, por si mënyrë për t’iu kundërvënë narrativave që i paraqesin si të dobëta ose të cenueshme. Në të gjitha intervistat u bë një dallim i qartë ndërmjet kritikës politike legjitime, e cila përgjithësisht pranohej si pjesë e garës elektorale, dhe akuzave personale shpifëse ose të rreme, të cilat konsideroheshin se kërkonin korrigjim për të parandaluar dëmtimin afatgjatë të reputacionit.

Dukshmëria dhe vëmendja mediatike

Shumica e të intervistuarave shprehën skepticizëm ndaj idesë se vëmendja e krijuar nga gjuha e urrejtjes mund të jetë politikisht e dobishme. Veçanërisht kur sulmet lidhen me çështje të ndjeshme si fëmijët, arsimi ose vlerat morale, kandidatet argumentuan se publiciteti negativ nuk përkthehet në angazhim domethënës të votuesve. Shumë prej tyre refuzuan shprehimisht viktimizimin si mjet fushate dhe nuk ishin të gatshme të shfrytëzonin vëmendjen armiqësore për të tërhequr mbështetje nga audienca që normalizon diskursin e urrejtjes.

Megjithatë, një e intervistuar artikuloi një perspektivë më të nuancuar, duke sugjeruar se rritja e dukshmërisë mund, në disa rrethana, të ridrejtohet për të demonstruar kompetencë dhe pjekuri politike. Sipas këtij këndvështrimi, efekti i vëmendjes varet nga aftësia e kandidates për ta riformuluar narrativën dhe për të kapërcyer tronditjen emocionale nga sulmi. Megjithatë, kjo perspektivë mbetet përjashtim dhe jo rregull, dhe tregon se aksesin e pabarabartë në aftësi mediatike, mbështetje institucionale dhe platforma publike mund të ndikojë nëse dukshmëria shndërrohet në pengesë apo në avantazh.

Narrativat gjinore dhe targetimi tematik

Intervistat tregojnë në mënyrë të vazhdueshme se ndikimi i gjuhës së urrejtjes formësohet më shumë nga targetimi tematik dhe inkuadrimi gjinor sesa nga vëllimi i saj. Sulmet që lidhen me fenë, moralin, edukimin seksual ose të drejtat e komunitetit LGBTI+ përshkruhen si veçanërisht të fuqishme, pasi mobilizojnë ankth më të gjerë shoqëror dhe mund të izolojnë politikisht kandidatet. Paraqitja në korniza të tilla shpesh e zhvendos debatin nga puna në nivel politikash drejt delegjitimitimit të bazuar në identitet.

Disa kandidate theksuan gjithashtu vazhdimësinë e narrativave mizogjene që minojnë faktorizimin politik të grave. Këto përfshijnë paraqitjen e grave si të varura nga figura politike mashkullore, si manipuluese ose moralisht të dyshimta, apo si figura ku pamja fizike konsiderohet më e rëndësishme se kompetenca. Të intervistuarat në përgjithësi i perceptojnë këto qasje si modele që intensifikohen me kalimin e kohës, duke përforcuar pengesat strukturore për pjesëmarrjen politike të grave dhe duke kufizuar hapësirën në të cilën gratë mund të vlerësohen vetëm mbi bazën e meritës profesionale.

3.4 Targetimi me bazë gjinore

Angazhimi online dhe ekspozimi ndaj targetimit

Gratë kandidate e përshkruajnë në përgjithësi angazhimin e tyre online si të qëllimshëm, të kontrolluar dhe të përqendruar në politika publike, me synim paraqitjen e punës institucionale, qëndrimeve politike dhe komunikimit me qytetarët, dhe jo përfshirjen në konfrontime. Shumë prej tyre shmangin në mënyrë të vetëdijshme reagimin ndaj komenteve ose përfshirjen në debate online, duke preferuar mesazhe pozitive, komunikim të drejtpërdrejtë përmes mesazheve private ose një theks më të madh në fushatën në terren. Reduktimi i aktivitetit online në disa raste lidhet me rrethana personale, por gjithashtu reflekton zgjedhje strategjike për të menaxhuar armiqësinë dhe për të ruajtur kapacitetin për angazhim politik.

Vlen të përmendet se gjetjet tregojnë se targetimi me bazë gjinore nuk varet nga sjellja agresive online. Edhe kandidatet që kanë ndjekur një stil komunikimi të përmbajtur dhe konstruktiv janë përballur me sulme gjinore, çka sugjeron se vetë prania online, dhe jo toni i komunikimit, mund të jetë e mjaftueshme për të nxitur armiqësi ndaj grave në role publike.

Toni i diskursit online dhe natyra e tij gjinore

“Çmimi është i lartë, por edhe ndikimi është i madh. Gratë sjellin ide, energji dhe udhëheqje që politika nuk mund ta përballojë t’i humbasë.”

Në të gjitha intervistat, toni i diskursit online për gratë në politikë përshkruhet si dukshëm më armiqësor dhe më degradues sesa ai ndaj burrave. Të intervistuarat i referohen vazhdimisht përdorimit të gjuhës seksiste, vulgare dhe poshtëruese, si dhe reagimeve shumë të polarizuara që shkojnë nga abuzimi i drejtpërdrejtë deri te lavdërimet e tepruara. Kjo dinamikë përjetohet si

demotivuese dhe përjashtuese, veçanërisht për gratë e reja dhe profesionistet që po konsiderojnë angazhimin në politikë.

Disa kandidate theksojnë se sulmet shpesh janë të organizuara dhe të amplifikuara, përfshirë përmes llogarive të rreme dhe mesazheve të koordinuara, duke përforcuar perceptimin se armiqësia gjinore nuk është thjesht spontane, por mund të mobilizohet në mënyrë strategjike. Si rezultat, mjedisi përshkruhet si toksik dhe emocionalisht rraskapitës, duke ngushtuar hapësirën për debat politik thelbësor dhe për angazhim kuptimplotë.

Faktorët nxitës të targetimit: ndërthurja e aktivitetit politik me gjininë

Ndërsa disa kandidate ua atribuojnë sulmet kryesisht punës së tyre politike, roleve institucionale ose interesave që kanë sfiduar, shumica pranojnë se gjinia vepron si faktor shumëfishues. Gratë shpesh perceptohen si “objektiva më të lehta”, dhe veprime të ngjashme politike kanë tendencë të shkaktojnë reagime më të personalizuar dhe më agresive kur ndërmerren nga gratë sesa nga burrat.

Disa të intervistuar theksuan se intensifikimi i sulmeve lidhet me kundërshtimin e interesave të rrënjësorë, përmes masave kundër korrupsionit, reformave ligjore, mbikëqyrjes së institucioneve publike ose politikave të ndjeshme socio-ekonomike. Megjithatë, këto sulme shpesh marrin formë gjinore, duke u mbështetur në norma patriarkale dhe pritje shoqërore. Edhe kandidatet që nuk e konsiderojnë gjininë si shkakun kryesor të sulmeve pranojnë se ajo ndikon ndjeshëm në mënyrën se si armiqësia shprehet dhe legjitimohet.

Përmbajtja e sulmeve: pamja fizike, familja dhe kompetenca

Një gjetje shumë e qëndrueshme është se targetimi me bazë gjinore përqendrohet në tri fusha të ndërlidhura: pamjen fizike, jetën familjare dhe kompetencën profesionale. Shumë kandidate raportojnë komente për veshjen, trupin ose shprehjet e fytyrës, shpesh të amplifikuara nga përdorimi selektiv i imazheve në media. Sulmet që lidhen me familjen përfshijnë thashetheme dhe insinuata për statusin martesor, marrëdhëniet ose rolet familjare, të stisura për të shfrytëzuar gjykimin dhe stigmatizimin shoqëror, veçanërisht jashtë qendrave urbane.

Kompetenca profesionale shpesh vihet në dyshim përmes pretendimeve përçmuese se gratë “nuk dinë mjaftueshëm” ose nuk kanë autoritet, edhe në raste kur kritika nuk mbështetet në argumente thelbësore. Këto forma të targetimit perceptohen gjerësisht nga të intervistuarat si të lidhura me gjininë dhe reflektojnë stereotipa të vazhdueshëm për përshtatshmërinë e grave për role udhëheqëse dhe vendimmarrëse.

Efektet më të gjera në pjesëmarrjen politike dhe hapësirën demokratike

Përtej dëmit individual, intervistat theksojnë edhe efektet më të gjera frenuese. Pritja e sulmeve me bazë gjinore bën që shumë gra të vetëcensurohen, të kufizojnë praninë e tyre online ose të shmangin plotësisht disa platforma. Kandidatet përshkruajnë zhvillimin e strategjive të përballimit, si moderimi i komenteve, distancimi emocional ose mpirja emocionale, jo si zgjidhje, por si mekanizma mbijetese në një mjedis armiqësor.

“Politika është sfiduese sepse prish interesat e vjetra. Sa më të forta të jenë qëndrimet tuaja, aq më të forta do të jenë reagimet. Kjo do të thotë se jeni duke vepruar drejt.”

Disa të intervistuarat theksojnë se kjo klimë dekurajon gra të afta të hyjnë në politikë dhe ngushton cilësinë e debatit publik. Në vend që të përqendrohet në politika dhe punë, diskursi online shpesh zhvendoset drejt degradimit personal, duke përfunduar pengesat strukturore për pjesëmarrjen e barabartë politike të grave.

3.5 Rekomandimet dhe reflektimet e grave

Forcimi i masave mbrojtëse ligjore dhe zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet

Një rekomandim dominues në të gjitha intervistat është nevoja për zbatim më të fortë dhe më të qëndrueshëm të kornizës ekzistuese ligjore që trajton dhunën, kërcënimet dhe gjuhën e urrejtjes ndaj grave në politikë. Disa të intervistuarat theksuan se dispozitat ligjore tashmë ekzistojnë, duke përfshirë referime specifike për dhunën psikologjike dhe gjuhën e urrejtjes, por ato mbeten kryesisht të pazbatuara. Mungesa e zbatimit të dukshëm të kuadrit ligjor u konsiderua si një faktor kyç që kontribuon në normalizimin e abuzimit. Të intervistuarat theksuan vazhdimisht se edhe një numër i vogël rastesh të trajtuara si duhet, që rezultojnë me reagime të qarta institucionale ose me sanksione, do të kishin efekt parandalues dhe do të dërgonin mesazhin se sjellje të tilla kanë pasojë.

Në të njëjtën kohë, të intervistuarat theksuan se liria e shprehjes nuk duhet të ngatërrohet si e drejtë për të abuzuar ose për të frikësuar. U kërkua reagim më i shpejtë institucional, profesionalizëm më i madh nga organet e zbatimit të ligjit dhe përgjegjësi më e qartë në rastet kur abuzimi vjen nga figura publike ose ndodh në hapësira institucionale, si parlamentet apo debatet televizive. Disa të intervistuarat theksuan gjithashtu nevojën për të rishikuar imunitetin parlamentar dhe pragjet ligjore në rastet kur gjuha fyese ose degraduese aktualisht justifikohet si “fjalim politik”.

Roli i partive politike: nga retorika te përgjegjësia

Të intervistuarat argumentuan vazhdimisht se partitë politike mbajnë përgjegjësi qendrore në adresimin e dhunës ndaj grave në politikë, por shpesh nuk veprojnë përtej zotimeve deklarative për barazinë gjinore. Partitë u inkurajuan të kalojnë nga mbështetja simbolike drejt mekanizmave të brendshëm të përgjegjësisë, përfshirë kode të sjelljes për gjuhën publike, sanksione të qarta për shkeljet dhe dënime në nivel të udhëheqjes ndaj

abuzimit me bazë gjinore, pavarësisht nëse gruaja e targetuar i përket apo jo të njëjtës parti.

Disa gra theksuan se partitë duhet t'i trajtojnë gratë si aktore dhe udhëheqëse politike, dhe jo si figura dekorative për lista elektorale ose paraqitje mediatike. Përfshirja simbolike, promovimi selektiv i grave “të bindura” ose “të paraqitshme”, si dhe heshtja përballë abuzimit u përshkruan si praktika që përforcojnë, dhe jo sfidojnë, hierarkitë gjinore të pushtetit. Të intervistuarat kërkuan gjithashtu që partitë të investojnë në mënyrë më sistematike në edukimin politik, në njohuritë mediatike dhe në zhvillimin e lidërshit, veçanërisht për gratë e reja.

Përgjegjësia e mediave, platformave dhe edukimi qytetar

Një tjetër temë e rëndësishme lidhet me rolin e mediave, platformave digjitale dhe edukimit qytetar në formësimin e mjedisit ku ndodh dhuna ndaj grave në politikë. Të intervistuarat theksuan praktikën e papërgjegjshme mediatike, amplifikimin selektiv të momenteve konfliktuale dhe normalizimin e gjuhës degraduese në debatin publik. Këto dinamika u konsideruan se ndikojnë drejtpërdrejt në sjelljen online dhe legjitimojnë abuzimin në nivel shoqëror.

Rekomandimet përfshijnë forcimin e etikës mediatike, raportimin e bazuar në fakte dhe reagime proaktive ndaj dezinformimit dhe sulmeve të koordinuara. Disa të intervistuarat theksuan se organizatat e shoqërisë civile kanë rol kyç në monitorimin e diskursit publik, në denoncimin e vazhdueshëm dhe të paanshëm të abuzimit dhe në krijimin e hapësirave për debat publik të informuar. Edukimi, si ai formal në shkolla ashtu edhe ai joformal përmes debatit publik, u identifikua vazhdimisht si një masë parandaluese afatgjatë kundër mizogjinisë dhe dhunës politike.

Solidariteti, aleancat dhe përgjegjësia kolektive

Të intervistuarat theksuan fort rëndësinë e solidaritetit, ndërmjet grave dhe në shoqëri në tërësi, si kundërpeshë ndaj dhunës ndaj grave në politikë. Ndërsa qëndrueshmëria personale dhe rrjetet informale të mbështetjes u përshkruan si thelbësore për mbijetesë, gratë theksuan se përgjegjësia nuk duhet të mbetet vetëm mbi ato që vihen në shënjestër. Disa të intervistuarat kërkuan që burrat në politikë të dënojnë në mënyrë aktive abuzimin me bazë gjinore dhe që shoqëria në tërësi ta trajtojë këtë sjellje si të papranueshme, dhe jo si një element normal të konkurrencës politike.

“Shumë gra para nesh e kanë pasur edhe më të vështirë. Përgjegjësia jonë është ta bëjmë hapësirën publike më të lehtë për gratë që do të vijnë pas nesh.”

Solidariteti ndërmjet grave u përshkrua jo vetëm si mbështetje emocionale, por edhe si domosdoshmëri strategjike për të kundërshtuar izolimin dhe stigmatizimin. Në të njëjtën kohë, të intervistuarat paralajmëruan se solidariteti informal nuk mund të zëvendësojë veprimin institucional dhe nuk duhet të shndërrohet në një barrë shtesë për gratë që të mbrojnë njëra-tjetrën në mungesë të garancive sistimore.

Mesazhe për gratë që po konsiderojnë kandidimin politik

Pavarësisht sfidave të përshkruara, të intervistuarat inkurajuan në mënyrë të qartë gratë të mbeten të angazhuara dhe të mos tërhiqen nga jeta politike. Mesazhet e tyre kombinojnë realizmin me vendosmërinë: politika është e vështirë, e polarizuar dhe shpesh armiqësore, por tërheqja vetëm do të përforconte strukturat që e mundësojnë dhunën ndaj grave në politikë. Shumë prej tyre e përshkruan këmbënguljen si një akt rezistence dhe përgjegjësie ndaj brezave të ardhshëm të grave.

Në të njëjtën kohë, të intervistuarat theksuan rëndësinë e përgatitjes, edukimit, ndërtimit të aleancave dhe qartësisë së qëllimit. Hyrja në politikë u lidh vazhdimisht me pasjen e një kauze, vlerave të forta personale dhe vetëdijes për kostot personale që mund të përfshijë ky angazhim. Disa gra theksuan në mënyrë të qartë se qëndrueshmëria e tyre personale nuk duhet të idealizohet apo të pritët nga të gjitha gratë, dhe se ndryshimi strukturor është i domosdoshëm për të siguruar që pjesëmarrja politike të mos varet nga një nivel i jashtëzakonshëm durimi dhe rezistence.

Reflektime mbi fushatën dhe vetëpozicionimin

Në retrospektivë, disa të intervistuarat reflektuan se abuzimi online i ka bërë më të kujdesshme në stilin e komunikimit ose më strategjike në mënyrën se si e paraqesin qëndrimin e tyre politik, veçanërisht në mjedise shumë të polarizuara. Megjithatë, shumica e tyre e refuzuan idenë se abuzimi duhet të ndryshojë ose ka ndryshuar në mënyrë thelbësore qëndrimet apo vlerat e tyre politike. Vazhdimi i angazhimit politik u paraqit vazhdimisht si përkushtim ndaj interesit publik, llogaridhënies dhe parimeve demokratike, dhe jo si reagim ndaj sulmeve.

Është e rëndësishme të theksohet se asnjë e intervistuar nuk e përshkroi abuzimin online si motivues pozitiv. Në rastet kur gratë kanë mbetur aktive politikisht, kjo ka ndodhur pavarësisht abuzimit dhe jo për shkak të tij. Ky dallim përforcon kuptimin se qëndrueshmëria nuk e mohon ekzistencën e dëmit, por reflekton kapacitete të pabarabarta për të përballuar dhunën ndaj grave në politikë.

3.6 Përfundime

Gjetjet tregojnë se gjuha e urrejtjes online dhe targetimi me bazë gjinore veprojnë si forma kumulative dhe sistemore të dhunës ndaj grave në politikë, duke riformësuar pjesëmarrjen politike jo vetëm përmes dëmit të drejtpërdrejtë emocional, por edhe duke mobilizuar presionin familjar, duke kufizuar vendimmarrjen dhe duke rritur koston personale të qëndrimit në jetën publike. Edhe kur kjo dhunë nuk çon në tërheqje të menjëhershme, ajo prodhon efekte të qëndrueshme në trajektoret politike të grave, duke ndikuar në mënyrën se si ato komunikojnë, zhvillojnë fushatën dhe vlerësojnë qëndrueshmërinë e angazhimit të tyre politik. Kjo ka pasoja afatgjata për përfaqësimin politik, ripërtëritjen politike dhe cilësinë e demokracisë.

Në mungesë të mekanizmave të strukturuar dhe të besueshëm të mbështetjes, gratë kandidate mbështeten kryesisht në përkrahjen familjare, solidaritetin informal dhe qëndrueshmërinë individuale, ndërsa partitë politike dhe institucionet e drejtësisë

shpesh dështojnë të ofrojnë mbrojtje të qëndrueshme, parimore dhe me kohë. Kjo mbështetje në strategji individuale të përballimit e zhvendos përgjegjësinë nga institucionet te individët, duke rritur barrën emocionale dhe shoqërore mbi gratë dhe duke përforcuar pabarazitë strukturore brenda proceseve elektorale dhe përfaqësuese. Në vend që të jetë përjashtim, targetimi me bazë gjinore shfaqet si një tipar i vazhdueshëm i pjesëmarrjes politike të grave, duke formësuar mënyrën dhe intensitetin e sulmeve përmes orientimit të armiqësisë ndaj pamjes fizike të grave, roleve familjare dhe kompetencës së perceptuar, si dhe duke ulur pragun për përdorimin e gjuhës me ngjyrimë personale dhe degraduese.

Përtej fushatave individuale, intervistat tregojnë edhe për kosto më të gjera demokratike. Abuzimi online dhe gjuha e urrejtjes ngushtojnë hapësirën për debat politik thelbësor, shpërblejnë polarizimin dhe sensacionalizmin dhe krijojnë nxitje për komunikim të thjeshtuar ose performativ në vend të angazhimit të thelluar me politikën publike. Edhe kandidatet që arritën rezultate të forta elektorale e përshkruan këtë mjedis si të dëmshëm për diskutimin demokratik dhe për konkurrencën përfshirëse politike.

Në tërësi, gjetjet theksojnë se dhuna ndaj grave në politikë nuk është një problem individual që kërkon qëndrueshmëri individuale, por një formë strukturore e dhunës politike që kërkon përgjigje të koordinuara ligjore, politike dhe shoqërore. Këmbëngulja e grave në politikë duhet të njihet si akt rezistence dhe jo si qëndrueshmëri që merret si e mirëqenë. Pa zbatim të besueshëm të ligjeve, pa udhëheqje politike të përgjegjshme, pa praktika etike mediatike dhe pa solidaritet kolektiv, dhuna ndaj grave në politikë do të vazhdojë të përcaktojë se kush është i gatshëm dhe i aftë të marrë pjesë në politikë, në çfarë kushtesh dhe me çfarë kostoje personale, duke minuar si barazinë gjinore ashtu edhe cilësinë e proceseve demokratike.

4. Përvojat e grave në nivel lokal

Kjo pjesë shqyrton përvojat e grave kandidate gjatë fushatave elektorale lokale, duke u mbështetur në intervista të thelluara të realizuara në disa komuna. Edhe pse zgjedhjet lokale shpesh perceptohen si më pak të polarizuara dhe me më pak dukshmëri se garat në nivel kombëtar, gjetjet tregojnë se gratë përballen me presione të vazhdueshme me bazë gjinore që ndikojnë jo vetëm në mirëqenien e tyre emocionale, por edhe në strategjitë e fushatës, pozicionimin politik dhe angazhimin e tyre afatgjatë. Afërsia e politikës lokale, ku kandidatët njihen personalisht në komunitetet e tyre, krijon një dinamikë të veçantë në të cilën abuzimi online, komentet informale dhe narrativat që lidhen me reputacionin ndërthuren drejtpërdrejt me jetën private dhe familjare.

Analiza që vijon shqyrton ndikimin emocional dhe psikologjik të gjuhës së urrejtjes, mekanizmat e mbështetjes në dispozicion, pasojat politike dhe ato që lidhen me zhvillimin e fushatës, modelet e targetimit me bazë gjinore dhe rekomandimet e vetë grave për reforma. Në tërësi, këto gjetje tregojnë se, edhe pse shumë gra shfaqin qëndrueshmëri dhe vendosmëri të madhe, pjesëmarrja e tyre vazhdon të zhvillohet brenda kufizimeve strukturore të formësuara nga norma të rrënjësura gjinore, reagime të pabarabarta institucionale dhe një kulturë politike që shpesh i nënshtrojnë gratë ndaj një vëzhgimi më të ashpër dhe një gjykimi disproporcional.

4.1. Ndikimi emocional dhe personal në nivel lokal

Presioni kumulativ emocional dhe psikologjik

Megjithëse zgjedhjet lokale në përgjithësi marrin më pak vëmendje mediatike sesa garat kombëtare, të intervistuarat e përshkruan gjuhën e urrejtjes dhe komentet negative si emocionalisht të rënduara dhe kumulative, dhe jo si incidente të izoluara. Edhe kur sulmet nuk janë të koordinuara ose virale, përsëritja e tyre gjatë periudhave të fushatës krijon presion të vazhdueshëm psikologjik.

Disa kandidate raportuan ndërgjegjësim të shtuar për mënyrën se si paraqiten në publik si pasojë e drejtpërdrejtë e komenteve seksiste dhe atyre që lidhen me pamjen fizike. Mesazhet private digjitale, shpesh me përmbajtje të seksualizuar ose vulgare, u përshkruan si veçanërisht ndërhyrëse. Një kandidate shpjegoi se ishte bërë jashtëzakonisht e vëmendshme për mënyrën se si vishej dhe paraqitej në publik, nga frika se votuesit mund të përqendroheshin më shumë në pamjen e saj sesa në mesazhin politik. Ky presion çoi në ulje të dukshmërisë publike dhe në ndryshim të dinamikës së fushatës.

Gra kandidate të tjera folën për lodhje emocionale dhe dekurajim kur kritikantët përqendroheshin në tipare personale dhe jo në politika apo punë. Edhe kandidatet me përvojë pranuan se komentet negative mund të “të prekin lehtësisht”, pavarësisht përpjekjeve për t’i injoruar. Natyra kumulative e këtij ekspozimi, veçanërisht gjatë periudhave intensive të fushatës, rezultoi në stres, lodhje emocionale dhe ulje të kapaciteteve.

Ndërhyrja në jetën private dhe familjare

Në nivel lokal, afërsia ndërmjet kandidatëve dhe komuniteteve krijon një formë të veçantë ekspozimi. Në komunat më të vogla, kandidatët njihen personalisht dhe familjet e tyre shpesh janë të përfshira në të njëjtat rrjete shoqërore. Kjo afërsi e intensifikon depërtimin e abuzimit në jetën private.

Të intervistuarat përshkruan se si komentet shpifëse, vërejtjet seksiste dhe armiqësia online ndikuan jo vetëm tek ato, por edhe tek anëtarët e familjes, të cilët ndjekin mediat lokale dhe platformat sociale. Për gratë që janë nëna, barra emocionale u rrit nga shqetësimet për ekspozimin e fëmijëve ndaj armiqësisë publike dhe për pasojat më të gjera shoqërore të dukshmërisë politike.

Në disa raste, anëtarët e familjes shprehën shqetësim ose e vunë në dyshim nëse angazhimi politik ia vlente përballë kostos emocionale. Edhe kur vetë kandidatet nuk e konsideruan seriozisht tërheqjen, shqetësimi i familjarëve e thelloi ndikimin psikologjik. Ky efekt pasqyron pritjet gjinore që lidhen me rolet e ofrimit të kujdesit dhe përforcon ndjenjat e përgjegjësisë, fajit dhe instinktit mbrojtës.

Efektet frenuese dhe disiplinuese në pjesëmarrjen e grave

Të intervistuarat identifikuan vazhdimisht efektin frenues si një nga pasojat më të rëndësishme të gjuhës së urrejtjes në nivel lokal. Edhe pse shumë prej tyre mbetën aktive politikisht, ato vërejtën hezitim të gra të tjera që po konsideronin angazhimin politik.

Politika shpesh u përshkrua si një mjedis “toksik” dhe shumë i polarizuar, që dekurajon gratë të pranojnë ftesa për të kandiduar ose edhe për të marrë pjesë në aktivitete partiake. Në komunitetet e vogla, rreziku për reputacionin dhe frika nga vëzhgimi i afërt publik mund të jenë pengesa veçanërisht të forta.

Normalizimi i komenteve seksiste, profilet e rreme që përhapin shpifje dhe kritikë e bazuara në pamjen fizike sinjalizojnë se pjesëmarrja politike shoqërohet me kosto personale dhe shoqërore. Në këtë kuptim, gjuha e urrejtjes funksionon si mekanizëm disiplinues në nivel komunal, duke ndikuar se kush ndihet i aftë ose i gatshëm të hyjë në jetën publike. Kjo dinamikë minon përfaqësimin përfshirës dhe dobëson ripërtëritjen demokratike.

Presioni për tërheqje dhe lodhja emocionale

Megjithëse shumica e kandidateve të intervistuar nuk u tërhoqën nga politika, shumë prej tyre përshkruan momente hezitimi, lodhjeje ose tërheqjeje strategjike. Presioni për tërheqje shpesh shfaqej në mënyrë indirekte përmes lodhjes emocionale, dyshimit në vetvete ose shqetësimit të familjes, dhe jo përmes kërcënimeve të drejtpërdrejta.

Disa kandidate reduktuan paraqitjet publike për të minimizuar ekspozimin. Të tjera reflektuan nëse kostoja emocionale, veçanërisht kur kombinohej me përgjegjësitë familjare, ishte e justifikuar. Pyetja “a ia vlen” u shfaq vazhdimisht, sidomos tek ato që balancojnë angazhimin politik me rolet e kujdesit familjar.

Është e rëndësishme të theksohet se këto presione mund të riformësojnë strategjitë e fushatës dhe dukshmërinë publike, edhe pa çuar në tërheqje formale. Reduktimi i ekspozimit ose delegimi i përfaqësimit mund të kufizojë praninë e drejtpërdrejtë të grave në konkurrencën elektorale, duke përforcuar në mënyrë të tërthortë pabarazitë gjinore në hapësirën politike.

Qëndrueshmëria, kapacitetet e pabarabarta dhe normalizimi i dëmit

Përvoja u shfaq si një faktor kyç që ndikon në kapacitetin për përballim. Kandidatet në mandatin e dytë ose të tretë raportuan vetëbesim më të madh dhe aftësi më të zhvilluar për të menaxhuar komentet armiqësore krahasuar me fushatat e tyre të para. Me kalimin e kohës, disa zhvilluan strategji përballimi, si distancimi emocional, angazhimi selektiv me komentet ose përqendrimi më i madh në punën konkrete rreth politikave.

Megjithatë, të intervistuarat theksuan se qëndrueshmëria është e pabarabartë. Kandidatet për herë të parë, gratë më të reja dhe ato që nuk kanë mbështetje të fortë partiake ose familjare u identifikuan si veçanërisht të cënueshme. Ndërsa distancimi emocional mund të ndihmojë në qëndrueshmërinë individuale, ai sjell riskun e normalizimit të armiqësisë si një komponent të pashmangshëm të pjesëmarrjes politike.

Është thelbësore të theksohet se qëndrueshmëria nuk duhet të interpretohet si mungesë e dëmit. Edhe kandidatet që deklaruan se sulmet nuk i preknin më personalisht pranuan pasojat më të gjera strukturore për përfaqësimin e grave dhe kulturën demokratike.

Ndikimi në diskursin politik dhe cilësinë e demokracisë lokale

Të intervistuarat e lidhën përvojën e tyre personale me shqetësime më të gjera për cilësinë e diskursit demokratik në nivel lokal. Kur fushatat zhvendosen nga propozimet politike dhe ofrimi i shërbimeve drejt komenteve seksiste, dezinformimit dhe sulmeve personale, zbehet debati mbi çështjet materiale.

Në zgjedhjet lokale, të cilat zakonisht përqendrohen në çështje praktike si infrastruktura, shërbimet dhe nevojat e komunitetit, deformime të tilla janë veçanërisht të dëmshme. Sulmet e personalizuar dhe ato me bazë gjinore shpërqendrojnë votuesit, ndikojnë qytetarët e pavendosur dhe dobësojnë besimin në proceset demokratike.

Për më tepër, kur gjuha e urrejtjes normalizohet në mjediset online lokale, ajo krijon precedent për fushatat e ardhshme. Gratë dhe të rinjtë që vrojtojnë këto dinamika mund të dekurajohen nga angazhimi politik, duke kufizuar kështu diversitetin dhe përfaqësimin në kuvendet komunale.

4.2 Mekanizmat mbështetës

Mbështetja familjare si mekanizëm kyç i qëndrueshmërisë

Në të gjitha intervistat, mbështetja familjare u shfaq si mekanizmi më i qëndrueshëm dhe vendimtar i qëndrueshmërisë për gratë candidate në nivel lokal. Mbështetja

emocionale, psikologjike dhe praktike nga bashkëshortët, prindërit dhe familjarët e ngushtë u përshkrua si shtylla kryesore që u mundëson grave të vazhdojnë angazhimin politik.

Disa kandidatë theksuan se mesazhet abuzive i përpunonin së bashku me partnerët e tyre, ndonjëherë duke e kthyer përmbajtjen fyese në humor si strategji përballimi. Një e intervistuar shpjegoi se ajo dhe bashkëshorti i saj i shndërronin mesazhet vulgare në shaka private për të "lehtësuar peshën" e përvojës. Edhe pse fillimisht ishte i tronditur nga ekspliciteti i disa mesazheve, bashkëshorti i saj më vonë u bë mbështetës aktiv i dukshmërisë së saj publike, duke këmbëngulur që ajo të vazhdonte të paraqitej në publik pavarësisht ngacmimeve.

Për gratë që janë nëna, mbështetja familjare u përshkrua jo vetëm si inkurajim emocional, por edhe si rishpërndarje praktike e përgjegjësi. Periudhat e fushatës kërkojnë kohë, mobilitet dhe burime financiare. Të intervistuarat theksuan se pa ndërhyrjen e anëtarëve të familjes për të marrë përsipër kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë, zhvillimi i një fushate të qëndrueshme do të ishte pothuajse i pamundur. Në këtë kuptim, mbështetja familjare funksionon njëkohësisht si mburojë emocionale dhe si strukturë mundësuese.

Megjithatë, kjo mbështetje nuk ishte gjithmonë pa tension. Disa kandidatë theksuan se anëtarët e familjes ndiheshin më të ngarkuar emocionalisht sesa vetë ato. Të afërmit ndonjëherë kërkonin kujdes më të madh ose inkurajonin tërheqjen nga angazhimi, duke reflektuar instinktin mbrojtës në një mjedis armiqësor publik. Megjithatë, solidariteti familjar mbeti burimi më i qëndrueshëm i qëndrueshmërisë.

Mbështetja nga partitë: selektive, e paqëndrueshme dhe shpesh e pamjaftueshme

Në kontrast me rolin e fortë të rrjeteve familjare, mbështetja nga degët lokale të partive u përshkrua si e pabarabartë, selektive dhe në shumë raste e pamjaftueshme.

Disa kandidatë raportuan përvoja pozitive, veçanërisht në degët që kishin prioritet barazinë gjinore, kishin ofruar trajnime dhe mentorim dhe kishin inkurajuar në mënyrë aktive pjesëmarrjen e grave. Në të paktën një komunë, mentorimi i strukturuar kishte ndihmuar që gratë të zgjidheshin përtej kuotës gjinore.

Megjithatë, shumë gra të tjera përshkruan mbështetje institucionale të kufizuar ose minimale. Disa kandidatë treguan se strukturat lokale të partisë ofronin shumë pak mbështetje të organizuar për reagimin ndaj gjuhës së urrejtjes. Organizimi i aktiviteteve të fushatës, sigurimi i hapësirave dhe mobilizimi i votuesve shpesh mbeteshin përgjegjësi e vetë kandidatëve. Mbështetja financiare, kur ofrohej, ishte simbolike dhe e paqëndrueshme. Një e intervistuar theksoi se në një fushatë të mëparshme gratë kandidatë kishin marrë një kontribut të vogël financiar, i cili edhe pse modest kishte sinjalizuar njohje. Në fushatat pasuese, edhe kjo diferencë minimale nuk ishte më e pranishme.

Kandidatët theksuan gjithashtu mungesën e reagimeve kolektive nga partitë ndaj sulmeve. Kur gjuha e urrejtjes ose dezinformimi kishte në shënjestër një kandidatë të caktuar, rrallëherë kishte reagim të koordinuar publik nga strukturat partiake. Të

intervistuarat sugjeruan se subjektet politike kanë detyrim të reagojnë në mënyrë kolektive kur përfaqësuesit e tyre sulmohen, veçanërisht në rastet e shpifjes ose abuzimit me bazë gjinore. Mungesa e reagimeve të tilla përforconte ndjenjën se kandidatet duhet ta menaxhojnë armiqësinë në mënyrë të pavarur.

Në disa raste, dinamika të brendshme partiake e shtuan edhe më shumë cenueshmërinë. Gratë që kishin ndryshuar parti ose që perceptoheshin si “të sapoardhura” raportuan se përballeshin me skepticizëm shtesë brenda strukturave partiake, gjë që kufizonte solidaritetin e brendshëm dhe aksesin në bazat ekzistuese të votuesve.

Solidariteti ndërmjet grave si mekanizëm informal mbështetjeje

Përtej familjes dhe strukturave formale partiake, solidariteti ndërmjet grave dhe rrjetet informale të bashkëpunimit luajtën një rol mbrojtës. Mbështetja shpesh vinte nga kolege, miq apo anëtarë të komunitetit që sfidonin publikisht komentet fyese ose ofronin mbështetje morale.

Në disa raste, gra të tjera reagues drejtpërdrejt ndaj komenteve abuzive në hapësirat online, duke përballur autorët ose duke shprehur mbështetje publike. Ky solidaritet informal ndihmoi në kundërbalancimin e izolimit dhe sinjalizoi se narrativat armiqësore nuk pranohen në mënyrë universale.

Megjithatë, ky solidaritet nuk ishte i institucionalizuar në mënyrë të qëndrueshme. Ai mbeti kryesisht spontan dhe i varur nga iniciativa individuale, dhe jo nga rrjete të organizuara të grave brenda partive ose ndërmjet partive. Edhe pse i vlefshëm, ai nuk e zëvendëson nevojën për mbështetje të strukturuar nga partitë apo institucionet.

Raportimi i abuzimit: përdorim selektiv dhe i kushtëzuar i mekanizmave formalë

Shumica e të intervistuarave raportuan se nuk i kanë raportuar formalisht rastet e gjuhës së urrejtjes ose abuzimit. U përmendën disa arsye për këtë model të përsëritur.

Së pari, shumë incidente u perceptuan se nuk e arrinin pragun ligjor të një vepre penale. Kandidatet bënë dallim ndërmjet komenteve fyese ose seksiste dhe kërcënimeve të drejtpërdrejta që mund të aktivizonin procedura penale. Në rastet që përfshinin profile të rreme ose sulme indirekte, të intervistuarat konsideronin se nuk kishte bazë të mjaftueshme për një ankesë formale.

Së dyti, disa kandidate shprehën keqardhje që nuk kishin raportuar incidentet, duke pranuar se heshtja mund të kontribuojë në normalizimin e tyre. Të tjera përshkruan edhe vetë procesin e raportimit si dekurajues. Një e intervistuar që kishte raportuar një kërcënim tregoi se ishte pyetur nëse autori e kishte kërcënuar shprehimisht me vrasje, çka sugjeron një interpretim të ngushtë të asaj që konsiderohet dëm që ndiqet ligjërisht. Reagime të tilla procedurale u përshkruan si demotivuese.

Në vend të raportimit formal, disa kandidate zgjedhën strategji reaktive, si përgjigje publike në seksionet e komenteve, korrigjim faktik të dezinformimit ose kërkesa direkte ndaj mediave për të filtruar komentet shpifëse. Në disa raste, mediat lokale i tërhoqën artikujt e pasaktë pas përgënjeshtërimeve faktike.

Në përgjithësi, raportimi mbeti selektiv dhe i kushtëzuar, falë perceptimeve për efektivitetin, pragjet ligjore dhe koston emocionale të ndjekjes së mekanizmave formalë.

Normalizimi i dhunës dhe vetëmenaxhimi si strategji mbijetese

Një temë e përsëritur në intervista ishte normalizimi i armiqësisë si një element i pritshëm i jetës politike. Shumë kandidatë përshkruan zhvillimin e strategjive individuale për përballim në vend të kërimit të ndërhyrjes institucionale.

Strategjitë më të zakonshme përfshinin injorimin e komenteve abuzive, distancimin emocional nga sulmet, ri-interpretimin e armiqësisë si shenjë e rëndësisë politike ose shndërrimin e kritikës në motivim. Familjarët shpesh këshillonin kandidatet “ta injorojnë” armiqësinë, duke përforcuar vetëmenaxhimin në vend të përshkallëzimit të situatës.

Ndërsa këto strategji mundësuan vazhdimin e pjesëmarrjes, ato gjithashtu sjellin riskun e përforcimit të një kulture në të cilën gjuha e urrejtjes trajtohet si e pashmangshme. Mungesa e reagimeve të strukturuar institucionale, e kombinuar me mbështetjen në qëndrueshmërinë personale, e zhvendos përgjegjësinë për menaxhimin e armiqësisë sistematike te vetë gratë.

Kjo dinamikë pasqyron një model më të gjerë, ku mbijetesa shpesh varet nga sistemet private të mbështetjes dhe qëndrueshmëria individuale, dhe jo nga llogaridhënia kolektive. Edhe pse shumë kandidatë treguan qëndrueshmëri dhe i dolën zot vetes, barra e menaxhimit të abuzimit mbetet e individualizuar në mënyrë disproporcionale.

4.3 Ndikimi politik dhe ai që lidhet me zhvillimin e fushatës

Ndikimi elektoral i gjuhës së urrejtjes

Të intervistuarat ofruan vlerësime të nuancuara nëse gjuha e urrejtjes kishte ndikuar në rezultatet e tyre elektorale. Në shumicën e rasteve, kandidatet nuk e perceptuan një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në rezultatin përfundimtar. Disa theksuan shprehimisht se, nëse gjuha e urrejtjes do të kishte ndikuar ndjeshëm te votuesit, ato nuk do të kishin arritur rezultate të forta elektorale, përfshirë renditjen ndër kandidatët më të votuar në komunat e tyre.

Në disa raste, kandidatet argumentuan se sulmet kishin efekt të kundërt për autorët e tyre. Padrejtësitë e perceptuara, narrativat shpifëse ose armiqësia e dukshme mobilizuan segmente të elektoratit në solidaritet. Votuesit që e njihnin personalisht kandidaten ose ishin të njohur me përvojën e saj profesionale i interpretuan sulmet si të padrejta, gjë që përforcoi mbështetjen e tyre. Një e intervistuar theksoi se përpjekjet për të minuar besueshmërinë e saj përfundimisht e forcuan pozicionin e saj, pasi votuesit reagues kundër asaj që e perceptuan si përpjekje të qëllimshme për ta dëmtuar reputacionin e saj.

Megjithatë, të intervistuarat pranuan edhe dinamika më komplekse. Gjuha e urrejtjes mund të mobilizojë njëkohësisht mbështetësit besnikë, ndërkohë që dekurajon votuesit e pavendosur që nuk kanë njohuri të detajuara për kandidaten. Në komunat më të vogla, ku rrjetet personale kanë rëndësi të madhe, njohja personale mund të neutralizojë narrativat negative. Në rastet kur kjo njohje është më e dobët, dezinformimi mund të krijojë konfuzion ose mëdyshje, duke kërkuar përpjekje shtesë për t'u kundërshtuar.

Edhe pse shumica e grave të intervistuarat nuk ia atribuuan humbjen elektorale drejtpërdrejt gjuhës së urrejtjes, ato pranuan se efektet e saj varen nga konteksti dhe mund të ndryshojnë në varësi nga dukshmëria, statusi si bartëse e mandatit dhe afërsia me komunitetin.

Ndikimi në strategjinë dhe zhvillimin e fushatës

Edhe pse ndikimi i drejtpërdrejtë elektoral shpesh u perceptua si i kufizuar ose madje pozitiv, gjuha e urrejtjes ndikoi qartë në strategjitë dhe mënyrën e zhvillimit të fushatës.

Disa kandidate përshkruan se kishin ndryshuar metodat e fushatës në përgjigje të narrativave armiqësore. Në vend që të mbështeteshin kryesisht në rrjetet sociale ose në tubime të mëdha publike, disa intensifikuan angazhimin e drejtpërdrejtë me qytetarët. Takimet derë më derë, tubimet e vogla dhe bisedat informale u përdorën si strategji për të anashkaluar armiqësinë online dhe për të rindërtuar besimin drejtpërdrejt me votuesit. Në disa raste, kandidatet kaluan shumë orë në takime personale gjatë periudhës së fushatës, duke i dhënë përparësi komunikimit të drejtpërdrejtë në vend të vetëpromovimit digjital.

Të tjera raportuan se u bënë më të kujdesshme dhe më vigjilente në komunikimin publik. Ndërgjegjësimi për “boshllëqet” e mundshme që kundërshtarët mund t'i shfrytëzonin çoi në mesazhe më të kontrolluara dhe në komunikim më të formalizuar në rrjetet sociale. Një kandidate reduktoi paraqitjet publike gjatë fushatës, ndërsa një tjetër e kufizoi dukshmërinë online vetëm në njoftime thelbësore dhe përmbajtje që lidhej me programin.

Gjuha e urrejtjes gjithashtu devijoi kohë dhe energji nga promovimi i politikave. Në vend që të fokusoheshin ekskluzivisht në propozimet programore, disa kandidate u detyruan t'i kushtonin përpjekje të konsiderueshme korrigjimit të dezinformimit, mbrojtjes së reputacionit dhe ruajtjes së kredibilitetit. Ky devijim i energjisë emocionale dhe strategjike përfaqëson një kosto të prekshme që lidhet me zhvillimin e fushatës.

Në të njëjtën kohë, disa të intervistuarat i interpretuan këto përshtatje si faktorë që e forcuan fushatën e tyre. Duke e zhvendosur fokusin drejt komunikimit faktik, mesazheve të bazuara në projekte dhe ndërveprimet personal, ato vlerësuan se ndërtuan marrëdhënie më të forta dhe më të qëndrueshme me votuesit.

Dukshmëria dhe vëmendja mediatike

Ndryshe nga niveli kombëtar, të intervistuarat në përgjithësi nuk raportuan se gjuha e urrejtjes kishte gjeneruar dukshmëri mediatike të dobishme. Në shumë raste, sulmet

ndodhën në hapësira private digjitale ose përmes platformave të kufizuara lokale online, pa u shndërruar në polemika më të gjera publike.

Për disa candidate, komentet negative mbetën kryesisht të kufizuara në kanalet personale dhe nuk u shndërruan në debat publik apo në vëmendje të amplifikuar. Në këto raste, përvoja u përshkrua si “e heshtur” dhe e targetuar individualisht, dhe jo e instrumentalizuar politikisht.

Megjithatë, në disa kontekste, polemikat publike rritën në mënyrë të tërthortë vëmendjen dhe njohjen. Kur narrativat shpifëse u bënë të dukshme në komunitet, disa votues reagues duke kontaktuar drejtpërdrejt kandidaten për të shprehur mbështetje. Në këto raste, vëmendja funksionoi si mekanizëm solidariteti dhe jo si dëmtim reputacioni.

Marrëdhënia ndërmjet gjuhës së urrejtjes dhe dukshmërisë në nivel lokal duket më e fragmentuar sesa në nivel kombëtar. Edhe pse sulmet rrallë gjeneronin amplifikim të strukturuar mediatik, ato ndonjëherë formësonin perceptimet brenda rrjeteve më të vogla komunitare.

Narrativat gjinore dhe targetimi tematik

Edhe pse jo të gjitha të intervistuarat përjetuan sulme shprehimisht gjinore, narrativat gjinore u shfaqën në disa prej rasteve individuale. Komentet që lidhen me pamjen fizike, për integritetin moral dhe stereotipet mbi kompetencën e grave ishin tema të përsëritura.

Në disa raste, sulmet u përqendruan në “përshtatshmërinë” e perceptuar të grave brenda strukturave partiake ose vunë në dyshim legjitimitetin e tyre si gra në hapësirën politike. Kandidatet raportuan se besueshmëria, lojaliteti ose karakteri i tyre personal shqyrtoheshin më imtësisht sesa propozimet e tyre politike. Një e intervistuar përmendi se ishte etiketuar ashtu që në mënyrë të nënkuptuar të pozicionohej si përçarëse ose jo-konformiste brenda mjediseve të dominuara nga burrat.

Sulme të tjera kishin për shënjestër kredibilitetin profesional, veçanërisht kur gratë kishin mbajtur role ekzekutive. Në këto raste, fushatat e dezinformimit u përqendruan në minimin e punës së mëparshme ose vendimeve administrative, duke kërkuar përpjekje të konsiderueshme për t'u përmbysur.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe kur armiqësia paraqitej në terma partiakë dhe jo përmes gjuhës shprehimisht gjinore, kandidatet vërejtën se gratë shpesh bartin pasoja për reputacionin në mënyrë disproporcionale. Në komunat më të vogla, gjykimi moral dhe narrativat shoqërore mund të lidhen më lehtë me identitetin publik të grave.

4.4 Targetimi me bazë gjinore

Angazhimi online dhe ekspozimi ndaj targetimit

Të intervistuarat raportuan nivele të ndryshme të aktivitetit online gjatë fushatave lokale, gjë që ndikoi si në ekspozimin e tyre ndaj abuzimit ashtu edhe në aftësinë për të menaxhuar ndërveprimin publik. Disa candidate ishin shumë aktive, duke përdorur

Facebook-un dhe në një masë më të vogël TikTok-un për të shpërndarë përmbajtje programore, për të njoftuar takime, për të publikuar video dhe për të mbledhur shqetësimet e qytetarëve përmes sondazheve dhe anketave. Të tjera përshkruan angazhim të kufizuar për shkak të mungesës së kohës ose të përvojës paraprake, duke u mbështetur kryesisht në fushatën në terren dhe në kontaktin e drejtpërdrejtë me votuesit.

Aty ku angazhimi online ishte më i lartë, kandidatet përshkruan ekspozim më të madh ndaj komenteve armiqësore, veçanërisht pas publikimit të fjalimeve, materialeve të fushatës ose paraqitjeve publike. Disa u përcaktuan për shmangie, duke reduktuar kohën në rrjetet sociale për disa ditë rresht, me qëllim mbrojtjen e mirëqenies emocionale. Për dallim, kandidatet që në mënyrë të qëllimshme e kufizuan vetëpromovimin online perceptuan ekspozim më të ulët, duke e interpretuar këtë si një strategji mbrojtëse të bazuar në përvojat e grave të tjera.

Gjetjet tregojnë se prania online nuk është vetëm mjet fushate, por edhe faktor risku. Dukshmëria dhe aktiviteti më i lartë mund të rrisin ekspozimin ndaj targetimit me bazë gjinore, ndërsa reduktimi i angazhimit digjital mund të funksionojë si taktikë për reduktimin e dëmit, shpesh në dëm të shtrirjes më të gjerë të komunikimit me votuesit.

Toni i diskursit online dhe natyra e tij gjinore

Në të gjitha komunat e analizuara, të intervistuarat e karakterizuan tonin e diskursit online për gratë në politikë si shpesh armiqësor, me cilësi të ulët dhe me dimension të theksuar gjinor. Përshkrimet varionin nga “i papërshtatshëm” dhe “jo profesional” deri te “toksik” dhe emocionalisht rraskapitës. Disa të intervistuarat theksuan se gratë përballen rregullisht me komente vulgare, objektivizuese ose hapur seksiste.

Edhe kur kritika nuk ishte drejtpërdrejt e seksualizuar, kandidatet përshkruan një ton të vazhdueshëm gjykues dhe nënvlerësues ndaj grave që janë aktive politikisht. Disa e lidhën këtë me polarizimin më të gjerë shoqëror, duke argumentuar se polarizimi politik në rritje nxit gjuhë armiqësore dhe normalizon gjuhën e urrejtjes në kategori të ndryshme identitare, përfshirë gjininë.

Është e rëndësishme të theksohet se dimensionin gjinor i diskursit shfaqet jo vetëm në gjuhën e përdorur, por edhe në standardet e aplikuara. Gratë vlerësohen më shpesh përmes prizmit personal dhe moral sesa përmes analizës së politikave apo kompetencës profesionale.

Faktorët nxitës të targetimit: ndërthurja e aktivitetit politik me gjininë

Të intervistuarat theksuan vazhdimisht se targetimi nxitet nga ndërveprimi ndërmjet faktit të të qenit grua dhe të qenit politikisht e dukshme ose aktive. Disa deklaruan se gratë janë më të lehta për t'u targetuar “në një nivel banal”, pasi sjelljet e përditshme si gjestet, toni i zërit ose mënyra e veshjes trajtohen si objekte legjitime të vëzhgimit dhe kritikës.

Një perceptim i përsëritur ishte se sa më e zëshme, më e vendosur ose më e dukshme të bëhet një grua në politikë, aq më të mëdha janë gjasat që ajo të jetë objekt sulmesh.

Kandidatet e lidhën këtë si me mizogjeninë ashtu edhe me konkurrencën politike. Gratë që perceptohen si pretendente serioze ose shumë aktive në kuvendet komunale sulmohen më shpesh. Në këtë kuptim, targetimi me bazë gjinore funksionon si diskriminim dhe njëkohësisht si mekanizëm kontrolli politik, duke sinjalizuar se prania publike e grave do të ndëshkohet në mënyrë shoqërore.

Disa të intervistuarat theksuan gjithashtu se gjinia ndërthuret me perceptimet për legjitimitetin brenda strukturave politike. Gratë që perceptoheshin si “aktore të jashtme” në strukturat partiake ose që sfidonin praktikën dominuese brenda kuvendeve komunale raportuan cenueshmëri më të madhe ndaj narrativave diskredituese.

Përmbajtja e sulmeve: pamja fizike, familja dhe kompetenca

Përmbajtja më e shpeshtë e sulmeve me bazë gjinore lidhej me pamjen fizike dhe feminitetin. Të intervistuarat përshkruan komente për veshjen, flokët, thonjtë, atributet fizike dhe paraqitjen trupore si pjesë të zakonshme të komenteve online. Disa raportuan se edhe detaje të parëndësishme shndërroheshin në objekt talljeje dhe, të paktën në një rast, mediat lokale e amplifikuan këtë diskurs duke prodhuar përmbajtje të bazuar në komente përqeshëse.

Sulmet që lidhen me kompetencën ishin gjithashtu të pranishme, por zakonisht shpreheshin përmes stereotipave gjinorë dhe jo përmes kritikës substanciale, për shembull insinuata se gratë “nuk i kuptojnë” çështjet teknike komunale si infrastruktura. Disa të intervistuarat theksuan se, nëse sulmet do të përqendroheshin në përmbajtjen e politikave, ato do të ishin më legjitime. Në vend të kësaj, komentet shpesh mbështeteshin në korniza seksiste që minojnë autoritetin e grave pavarësisht punës së tyre.

Sulmet që lidhen me familjen dhe jetën private u shfaqën në disa raste individuale. Disa kandidate deklaruan se nuk u targetuan drejtpërdrejt përmes komenteve që lidhen me familjen, ndërsa të tjera përshkruan sulme të lidhura me statusin martesor, reputacionin moral ose insinuata që synonin të dëmtonin pozitën e tyre shoqërore. Kur familja përfshihej në këto narrativa, dëmi shtrihej përtej kandidates, pasi familjarët ndiheshin të detyruar të tërhiqeshin nga rjetet sociale për të shmangur ekspozimin ndaj përmbajtjes poshtëruese.

Intervistat sugjerojnë një ndarje të qartë gjinore në përmbajtjen e sulmeve. Burrat sulmohen më shpesh për korrupsion ose paaftësi profesionale, ndërsa gratë më shpesh targetohen përmes pamjes fizike, seksualitetit, moralit dhe stereotipave gjinorë për aftësitë e tyre.

Efektet më të gjera në pjesëmarrjen politike dhe hapësirën demokratike

Të intervistuarat e lidhën targetimin me bazë gjinore me pasoja më të gjera për pjesëmarrjen politike dhe cilësinë e demokracisë në nivel lokal. Disa theksuan se mjediset armiqësore online i dekurajojnë gratë, veçanërisht kandidatet për herë të parë, të hyjnë në politikë për shkak të frikës nga dëmtimi i reputacionit dhe dëmi emocional. Ndjenja se gratë “nuk merren seriozisht” u përmend vazhdimisht si shkak dhe njëkohësisht si pasojë e targetimit me bazë gjinore.

Kandidatet theksuan gjithashtu ndikimin në diskutimin demokratik. Kur debati formësohet nga përqeshja seksiste dhe jo nga diskutimi programor, vëmendja publike largohet nga prioritetet komunale dhe zgjedhjet e politikave publike. Kjo dobëson llogaridhënien dhe kontribuon në një kulturë politike ku sulmet personale zëvendësojnë konkurrencën substanciale.

Për më tepër, disa të intervistuarat theksuan se normalizimi i këtij diskursi krijon një efekt frenues edhe brenda kuvendeve komunale, ku disa gra bëhen më të kujdesshme ose më pak të zëshme në fazat e hershme të mandatit të tyre. Rezultati kumulativ është ngushtimi i hapësirës politike. Më pak gra ndihen të sigurta për të marrë pjesë plotësisht në jetën politike dhe cilësia e përfaqësimit demokratik në nivel lokal zbehet.

4.5 Rekomandimet dhe reflektimet e grave

Forcimi i masave mbrojtëse ligjore dhe zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet

Në të gjitha intervistat, gratë theksuan se kuadri ligjor ekziston formalisht, por kërkon zbatim më të fortë dhe pasoja të dukshme. Disa të intervistuarat theksuan se fushatat ndërgjegjësuere nuk janë të mjaftueshme. Rastet konkrete të sanksionimit të gjuhës së urrejtjes do të kishin efekt më të madh parandalues. Shembujt publikë të hetimit dhe ndëshkimit, në përputhje me legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe integritetin, u identifikuan si sinjale të domosdoshme se abuzimi ka pasoja.

Disa kandidate kërkuar shprehimisht ndjekje penale në rastet e gjuhës së rëndë të urrejtjes, duke argumentuar se vetëm zbatimi efektiv i ligjit mund ta reduktojë këtë dukuri. Të tjera theksuan hendekun ndërmjet barazisë formale në ligj dhe pabarazisë informale në praktikë. Megjithatë mekanizmat institucionalë ekzistojnë në mënyrë formale, gratë vërejtën se normat shoqërore dhe qëndrimet patriarkale e dobësojnë efektivitetin e tyre në praktikë. Perceptimi se gratë “nuk mund t’ia lejojnë vetes të bëjnë gabime” në jetën publike pasqyron një pabarazi strukturore që mjetet ligjore më vete nuk mund ta adresojnë lehtë.

Rekomandimet theksuan nevojën për vullnet institucional më të fortë, për rrugë më të qarta raportimi dhe për ndjekje më të qëndrueshme të rasteve të abuzimit online dhe dezinformimit.

Roli i partive politike: nga retorika te përgjegjësia

Të intervistuarat theksuan vazhdimisht se partitë politike duhet të kalojnë përtej angazhimeve retorike për barazinë gjinore dhe të marrin përgjegjësi aktive për mbrojtjen e grave kandidate.

Propozimet përfshinin:

- ♦ *krijimin e mekanizmave të brendshëm në kuadër të degëve partiake për identifikimin, raportimin dhe reagimin publik ndaj gjuhës së urrejtjes*
- ♦ *ofrimin e mentorimit dhe trajnimeve të strukturuar për gratë që hyjnë në politikë*

- ◆ *sigurimin e mbështetjes financiare dhe logjistike gjatë fushatave*
- ◆ *garantimin e trajtimit të barabartë të grave kandidate në bazë të meritës dhe jo të lojalitetit apo “nënshtrimit” a “servilitetit”*
- ◆ *mbrojtjen publike të kandidateve që bëhen objekt i dezinformimit ose sulmeve seksiste*

Disa gra theksuan se reagimi kolektiv i partive ndaj sulmeve është thelbësor. Heshtja e udhëheqjes partiake kur një grua kandidate është objekt sulmi përforcon normalizimin e abuzimit dhe i lë kandidatet të izoluar. Partitë u inkurajuan të kundërshtojnë në mënyrë proaktive narrativat e rreme, të refuzojnë diskursin seksist dhe të fuqizojnë zërin e grave përmes ekspozimit mediatik dhe platformave të fushatës.

Përveç kësaj, disa të intervistuarat propozuan krijimin e platformave ndërpartiake të grave përfaqësuese politike për të avancuar iniciativa të përbashkëta legislative dhe për të adresuar në mënyrë të përbashkët gjuhën e urrejtjes dhe dhunën me bazë gjinore në politikë. Kjo reflekton njohjen se targetimi me bazë gjinore nuk njeh kufij partiakë.

Përgjegjësia e mediave, platformave dhe edukimi qytetar

Të intervistuarat theksuan përgjegjësinë e mediave lokale dhe platformave digjitale në formësimin e diskursit politik. Disa prej tyre theksuan nevojën për moderim më të rreptë të seksioneve të komenteve dhe për përgjegjësi më të madhe në publikimin e përmbajtjes shpifëse ose poshtëruese.

Rekomandimet përfshinin:

- ◆ *filtrimin ose largimin e komenteve poshtëruese dhe seksiste*
- ◆ *shmangien e amplifikimit sensacionalist të narrativave triviale ose të bazuara në pamje fizike*
- ◆ *promovimin e përfaqësimit të balancuar të grave kandidate*
- ◆ *ofrimin e hapësirës së shtuar mediatike për gratë që të artikulojnë prioritetet e tyre politike*

Përtej institucioneve mediatike, të intervistuarat theksuan rëndësinë e edukimit më të gjerë qytetar. Normalizimi i gjuhës mizogjene në bisedat e përditshme u identifikua si një shkak rrënjësor që më vonë shfaqet edhe në mjediset online. Gratë theksuan se ndryshimi shoqëror duhet të fillojë nga gjuha dhe qëndrimet e përditshme, veçanërisht te gjeneratat e reja.

Fushatat e ndërgjegjësimit publik, veçanërisht ato që theksojnë dëmin psikologjik të abuzimit online, u konsideruan komponentë të rëndësishëm të ndryshimit kulturor afatgjatë.

Solidariteti, aleancat dhe përgjegjësia kolektive

Solidariteti u shfaq si një temë e përsëritur në intervista. Kandidatet theksuan rëndësinë që gratë të organizohen në mënyrë kolektive, brenda dhe ndërmjet partive, për të reduktuar izolimin dhe për të rritur dukshmërinë. Të qenët “më të shumta” në kuvendet komunale u përshkrua jo vetëm si përfaqësim, por edhe si formë mbrojtjeje. Sa më e madhe prania e grave, aq më i vështirë bëhet targetimi i individëve.

Mbështetja familjare u njoh sërish si themelore, veçanërisht si mbështetje emocionale gjatë periudhave të fushatës. Megjithatë, disa të intervistuarat theksuan se solidariteti duhet të shtrihet përtej familjes dhe rrjeteve informale drejt aleancave institucionale dhe ndërpartiake.

Përgjegjësia kolektive u inkuadrue edhe në nivel shoqëror. Qytetarët u inkurajuan të reflektojnë mbi gjuhën që përdorin dhe të shmangin normalizimin e komenteve poshtëruese. Të intervistuarat sugjeruan se transformimi kulturor kërkon angazhimin e votuesve, shoqërisë civile, anëtarëve të partive dhe aktorëve mediatikë.

Mesazhe për gratë që po konsiderojnë kandidimin politik

Pavarësisht përshkrimit të mjediseve armiqësore, të intervistuarat përcollën mesazhe të forta inkurajuese për gratë që po konsiderojnë kandidimin në nivel komunal.

Temat kryesore përfshinin:

- ◆ *të mos dekurajohen nga komentet negative*
- ◆ *të mbeten të sigjerta dhe besnike ndaj vlerave të tyre*
- ◆ *të këmbëngulin, veçanërisht përballë stereotipave*
- ◆ *të fokusohen në kompetencë, përgatitje dhe objektiva konkrete*
- ◆ *të kërkojnë rrjete mbështetëse dhe mundësi mentorimi*

Disa gra theksuan rëndësinë e autenticitetit, veçanërisht në komunikimin me gjeneratat e reja që vlerësojnë sinqeritetin dhe transparencën. Të tjera i inkurajuan gratë ta shohin angazhimin politik si mundësi për të sjellë ndryshim real në komunitetet e tyre.

Mesazhi i këmbënguljes ishte i pranishëm në mënyrë të theksuar. Të intervistuarat theksuan se shumë gra kanë arritur sukses pavarësisht pengesave dhe se vetë pjesëmarrja e vazhdueshme sfidon normat diskriminuese.

Reflektime mbi fushatën dhe vetëpozicionimin

Në reflektimet retrospektive, të intervistuarat dhanë vlerësime të ndryshme mbi mënyrën se si abuzimi online ndikoi në vetëpozicionimin e tyre gjatë fushatës.

Disa raportuan se abuzimi nuk ndryshoi mesazhin thelbësor apo identitetin e fushatës së tyre. Ato mbetën të përqendruara në përmbajtjen programore, idetë për qeverisje dhe

propozimet politike, duke refuzuar me vetëdije ta përqendrojnë fushatën në mbrojtjen personale.

Të tjera pranu përshtatje konkrete. Armiqësia online i shtyu disa të reduktojnë aktivitetin në rrjetet sociale, të kufizojnë vetëpromovimin ose të shmangin reagimet ndaj provokimeve. Në disa raste, kandidatet e zhvendosën fokusin drejt takimeve të drejtpërdrejta me votuesit, duke i dhënë përparësi ndërveprimit personal në vend të ekspozimit digjital. Disa shmangën reagimet emocionale dhe u përqendruan në komunikim të bazuar në fakte dhe në mesazhe të lidhura me projekte konkrete.

Disa përshkruan edhe reagime më strategjike, si ekspozimi publik i sulmeve të koordinuara nga profile të rreme, gjë që në disa raste reduktoi targetimin e mëtejshëm.

Reflektimet nxjerrin në pah një tension ndërmjet qëndrueshmërisë dhe përshtatjes. Edhe pse shumë gra refuzuan që abuzimi të ripërcaktojë identitetin e tyre politik, disa ndryshuan strategjitë e komunikimit për të reduktuar riskun dhe për të mbrojtur kredibilitetin. Këto përshtatje ilustrojnë se si armiqësia me bazë gjinore ndikon në mënyrë të tërthortë në projektimin e fushatës dhe në pozicionimin publik.

4.6 Përfundime

Gjetjet nga analiza në nivel lokal tregojnë se gjuha e urrejtjes dhe targetimi me bazë gjinore përbëjnë një sfidë strukturore të vazhdueshme për pjesëmarrjen politike të grave në nivel lokal. Edhe pse fushatat lokale shpesh marrin më pak vëmendje mediatike dhe janë më pak të polarizuara në mënyrë të dukshme se garat kombëtare, pasojat emocionale, politike dhe demokratike të abuzimit online mbeten të konsiderueshme.

Së pari, në nivel personal, gjuha e urrejtjes gjeneron presion psikologjik kumulativ, ndërhyr në jetën familjare dhe krijon presion për tërheqje, edhe në rastet kur gratë përfundimisht mbeten aktive politikisht. Kjo barrë nuk kufizohet vetëm te vetë kandidatet. Ajo shtrihet edhe te familjarët dhe rrjetet e tyre të ngushta, duke përfortuar pritjet gjinore që lidhen me rolet e kujdesit dhe përgjegjësinë e reputacionit. Megjithatë shumë gra tregojnë qëndrueshmëri dhe e shndërrojnë armiqësinë në motivim, kjo qëndrueshmëri nuk duhet ta fshehtë koston emocionale disproporcionale që u imponohet atyre.

Së dyti, mekanizmat e mbështetjes në nivel lokal janë kryesisht informalë dhe të përqendruar në familje. Reagimet institucionale dhe ato të partive politike janë të pabarabarta, reaktive dhe shpesh të pamjaftueshme. Mekanizmat formalë të raportimit përdoren rrallë për shkak të perceptimit për joefektivitet, pragjeve të larta të provave dhe përvojave dekurajuese procedurale. Si rezultat, gratë mbështeten në strategji të vetëmenaxhimit dhe solidaritet informal, në vend të mbrojtjes së strukturuar institucionale. Ky individualizim i reagimit pasqyron njëkohësisht përparësi individuale dhe dobësi sistemore.

Së treti, gjuha e urrejtjes nuk e përcakton në mënyrë të njëtrajtshme rezultatin elektoral. Në disa raste, ajo mobilizoi mbështetësit dhe përforcoi perceptimet për padrejtësi. Megjithatë, ndikimi i saj shfaqet më pak në numrin përfundimtar të votave dhe më shumë në formësimin e kushteve të fushatës. Gratë përshtatën strategjitë e tyre duke

reduktuar dukshmërinë digjitale, duke intensifikuar kontaktin e drejtpërdrejtë me votuesit dhe duke ridrejtuar energjinë drejt mbrojtjes së reputacionit dhe korrigjimit faktik të dezinformimit. Këto përshtatje, edhe pse ndonjëherë efektive, përfaqësojnë reagime ndaj armiqësisë dhe jo strategji politike të zgjedhura në mënyrë të lirë. Në këtë kuptim, gjuha e urrejtjes funksionon si presion strukturor që ndikon në mënyrën se si gratë zhvillojnë fushatat, sa të dukshme zgjedhin të jenë dhe si e shpërndajnë energjinë e tyre politike.

Së katërti, targetimi me bazë gjinore në nivel lokal karakterizohet nga një model i qartë: sulmet përqendrohen kryesisht në pamjen fizike, seksualitetin, reputacionin moral dhe stereotipat gjinorë për kompetencën. Edhe kur paraqiten si kritikë politike, komentet shpesh reflektojnë standarde të ndryshme që aplikohen për gratë dhe burrat. Targetimi intensifikohet për gratë që janë më të zëshme, më të dukshme ose politikisht konkurruese, duke përfshirë funksionin disiplinues të abuzimit online. Kjo dinamikë shtrembëron konkurrencën elektorale dhe dobëson cilësinë e diskursit demokratik në politikën komunale.

Së fundi, gratë kandidate artikulojnë rekomandime të qarta që përqendrohen në zbatimin më të fortë të masave mbrojtëse ligjore, rritjen e përgjegjësisë së partive politike, moderimin më të përgjegjshëm të mediave, mentorimin dhe trajnimin për gratë që hyjnë në politikë, si dhe solidaritetin ndërpartiak ndërmjet grave. Reflektimet e tyre theksojnë një realitet të dyfishtë: gratë mbeten të vendosura për të marrë pjesë dhe për të udhëhequr, por vazhdojnë të veprojnë në mjedise të formësuara nga normat patriarkale të rrënjosura në shoqëri dhe nga mbështetja institucionale e pamjaftueshme.

Në përfundim, gjuha e urrejtjes në nivel lokal rrit koston personale të angazhimit politik për gratë dhe kufizon pjesëmarrjen demokratike përfshirëse. Adresimi i këtyre dinamikave kërkon jo vetëm qëndrueshmëri individuale, por reforma sistemore që përfshijnë forcimin e mekanizmave zbatues, rritjen e përgjegjësisë së partive, përmirësimin e praktikave mediatike dhe ndërtimin e llogaridhënies kolektive. Pa këto ndryshime, demokracia në nivel lokal rrezikon të mbetet formalisht përfshirëse, por në thelb e pabarabartë.

Katalogimi në botim (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës – Pjetër Bogdani

364.63-055.2:004(496.51)"2026"(047)

Krasniqi, Rezarta Delibashzade

Kostoja e dukshmërisë : dhuna online ndaj grave në jetën politike në Kosovë : shkurt 2026 / Rezarta Delibashzade Krasniqi. - Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2026. - 54 f. : ilustr. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-823-61-6



Instituti “Demokraci për zhvillim” (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup analistësh të cilët ishin gjithnjë e më të shqetësuar se procesi i shtet-ndërtimit e kishte anashkaluar demokracinë. Vizioni i D4D është promovimi i një qytetarie aktive dhe të informuar, që merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe që përdor arenën publike të përfaqësimit dhe vendimmarrjes për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus mbi ndarjen e burimeve në mënyrë efikase, të zgjuar dhe afatgjatë, duke kontribuar në zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politika konkrete, promovon një qasje ndërsektoriale ndaj zgjidhjes së problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime graduale dhe duke vepruar me efektivitet maksimal për të kontribuar në stabilizimin dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.



Për më shumë informacion rreth aktiviteteve të D4D, ju lutemi vizitoni uebsajtin tonë:
www.d4d-ks.org

ISBN 978-9951-823-61-6



9

789951

823616